



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU  
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY



---

# STRATEGJIA E **SIGURIMIT** TË **CILËSISË** PËR **ARSIMIN** PARAUNIVERSITAR NË **KOSOVË**

---

2016-2020

---





## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	5
1. Hyrje .....	7
2. Analiza e gjendjes.....	9
2.1. Hyrje .....	9
2.2. Mekanizmat e Sigurimit të Cilësisë .....	9
2.3. Planifikimi Zhvillimor i Shkollës.....	10
2.4. Ngritja e kapaciteteve .....	11
2.5. Vetëdijesimi .....	12
2.6. Financimi .....	14
3. Qëllimi dhe objektivat strategjike.....	15
Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë .....	17
Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune.....	21
Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet .....	24
Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë.....	27
4. Udhërrëfyesi për zbatimin e Strategjisë .....	29
5. Buxheti dhe plani i veprimit .....	34
Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë .....	36
Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune.....	39
Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet .....	40
Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë.....	45
Referencat.....	47

## Lista e shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
NGAB	Ngritja e kapaciteteve për Arsimin Bazik
EAQ	Evropa dhe Azia Qendrore
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Bashkëpunim
PISA	Program për Vlerësim Ndërkombëtar të Studentëve
SC	Sigurimi i Cilësisë
PZSHH	Planifikimi Zhvillimor i Shkollës
SËOT	Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Përmbledhje ekzekutive

Sigurimi i cilësisë është një ndër pikat më të dobëta të arsimit parauniversitar në Kosovë. Mekanizmat që ekzistojnë më herët, si Enti Pedagogjik i Kosovës, entet pedagogjike komunale dhe pedagogët në shkolla, u zhbënë në vitin 2000, me një vendim të UNMIK-ut, pa i zëvendësuar ato me mekanizma të rinj funksionalë. Ndërkohë, u krijuan institucione si Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Inspeksioni i Arsimit, por detyrat e tyre ishin tjera nga sigurimi i cilësisë. Po ashtu, në shtatë vitet e fundit vërehet një trend i ripunësimit të pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, por veprimtaria e tyre mbetet e jo e koordinuar dhe jo e mbikëqyrur nga jashtë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Ligji për Arsimin në Komuna solli risi edhe në fushën e sigurimit të cilësisë, duke i bartur disa autorizime për këtë fushë nga niveli qendror në atë lokal. Megjithatë, aprovimi i këtij ligji i zuri komnatat të papërgatitura nga aspekti kadrovik, por edhe logjistike, për një sfidë të tillë çfarë është sigurimi i cilësisë, aq më parë kur nuk ekziston një sistem unik për sigurimin e cilësisë në vend.

Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016" ka mbështetur nismën e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) që të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse për sigurimin e cilësisë. Procesi i planifikimit strategjik është zhvilluar në periudhën shtator 2014-korrik 2015 dhe është karakterizuar me pjesëmarrje të lartë të të gjitha palëve me interes, duke filluar nga zyrtarët e MASHT-it e deri tek përfaqësuesit e komunave, ekspertët dhe drejtorët e shkollave.

Procesi i planifikimit ka filluar me një analizë të gjendjes, e cila është realizuar me metodën SWOT. Analiza ka treguar se pikat më të dobëta të sigurimit të cilësisë në Kosovë janë ndarja e përgjegjësive ndërmjet institucioneve arsimore të tri niveleve (Ministria, komuna, shkolla), kapacitetet e këtyre institucioneve që t'i menaxhojnë detyrat e veta, qasja josistematike ndaj procesit të planifikimit zhvillimor në nivel shkollë dhe komune, si dhe, në përgjithësi, vetëdija e ulët për problemin e cilësisë së arsimit në Kosovë.

**Qëllimi i kësaj strategjie është të prezantojë një Sistem të plotë të Sigurimit të Cilësisë në nënsektorin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit.**

Kjo strategji ka katër komponentë të ndryshme, të përfaqësuar përmes objektivave strategjike dhe masave të ndërlidhura me to:

Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë

- Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës
- Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim
- Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së
- Definimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA
- Funksionimi i Inspektoratit në aspektin juridiko-administrativ dhe pedagogjik-profesional
- Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve
- Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

#### Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune

- Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor
- Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave
- Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë
- Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira

#### Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

- Ngritja e kapaciteteve të Inspektimit për përgjegjësitë e reja
- Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë
- Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë
- Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal
- Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor
- Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla

#### Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë

- Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare
- Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve
- Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë
- Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim
- Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë

Të gjitha masat janë përshkruar në hollësi, ndërsa përshkrimet janë pasuar me një udhërrëfyes ku prezantohen treguesit e suksesit për secilin objektiv të ndarë në dy periudha kohore, 2016-2017 dhe 2018-2020 dhe, po ashtu, është prezantuar ndërlidhja në mes të masave dhe objektivave të ndryshme. Buxheti për zbatimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2016-2020 është rreth 8.2 milion euro dhe kalkuluar në bazë të parashikimit të shpenzimeve për zbatimin e masave të kësaj Strategjie, pavarësisht nga fakti nëse në Buxhetin e Kosovës janë parashikuar mjete për këtë qëllim ose jo. Tabela në vijim jep përmbledhjen e këtij buxheti sipas viteve dhe komponentave të Strategjisë që përputhen me objektivat strategjike.

Komponenta	Buxheti					
	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
Mekanizmat për sigurimin e cilësisë	€ 452,600	€ 1,019,200	€ 1,554,700	€ 2,027,200	€ 2,474,700	€ 7,528,400
Planifikimi zhvillimor	€ 63,000	€ 0	€ 0	€ 0	€ 0	€ 63,000
Ngritja e kapaciteteve	€ 176,000	€ 166,700	€ 108,700	€ 61,500	€ 31,500	€ 544,400
Ngritja e vetëdijes	€ 50,500	€ 38,000	€ 3,000	€ 3,000	€ 3,000	€ 97,500
	<b>€ 742,100</b>	<b>€ 1,223,900</b>	<b>€ 1,666,400</b>	<b>€ 2,091,700</b>	<b>€ 2,509,200</b>	<b>€ 8,233,300</b>

# 1. Hyrje

Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016", ka mbështetur zhvillimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse të SC-së për Arsimin Parauniversitar të Kosovës dhe planin për zbatimin e saj në kuadër të Komponentit 2 ("Siguria e Cilësisë në Arsim"), Aktiviteti 2.1 {" Mbështetje për zhvillimin e një sistemi të sigurimit të cilësisë të bazuar në praktikën e mira të BE-së "}. Për të mbështetur këtë aktivitet, janë ndërmarrë dy hapa përgatitorë:

- 1) Rishikimi i instrumenteve ekzistuese të Sigurimit të Cilësisë (SC) në nivel shkolle, DKA dhe MASHT është realizuar nga grupi i ekspertëve austriakë. Raporti bazohet në një numër të intervistave të kryera me MASHT-in dhe zyrtarët e DKA-ve si dhe drejtorët e shkollave, dhe ofron një analizë të gjendjes në fushën e sigurimit të cilësisë dhe rekomandime për fushat prioritare që do të trajtohen nga Strategjia e SC-së.
- 2) Grupi punues 18-anëtarësh, i përbërë nga përfaqësues të MASHT-it, DKA-ve, drejtorë të shkollave dhe ekspertë, është themeluar nga MASHT-i për të udhëhequr procesin e planifikimit të Strategjisë. Kriteret për anëtarësi dhe Termat e Referencës janë zhvilluar nga Projekti. Ekipi redaktues është emëruar nga anëtarët e grupit punues për të marrë përsipër përgjegjësinë për hartimin e dokumentit të Strategjisë.

Procesi i planifikimit të Strategjisë u zhvillua në nëntë faza:

Faza e parë: Formimi i Ekipit të Planifikimit të Strategjisë

MASHT-i ka zgjeruar Grupin punues me 12 anëtarë të tjerë për të formuar Ekipin e Planifikimit të Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë (SC). Ekipi përfaqëson gamë të gjerë të aktorëve duke përfshirë autoritetet qendrore dhe lokale, ekspertë, profesionistë, prindër, shoqërinë civile dhe partnerë zhvillimorë. Anëtarë të tjerë janë rekrutuar nga radhët e MASHT-it dhe stafit të DKA-ve, drejtorëve të shkollave, Instituti Pedagogjik, Fakulteti i Edukimit, trajnuesit e mësuesve dhe partnerëve zhvillimorë. Detyra kryesore e ekipit është që të sigurojë të dhëna për procesin e planifikimit të strategjisë dhe komentojë draft dokumentin, ndërsa Grupi punues do të vazhdojë të drejtojë procesin.

Faza e dytë: Analiza e situatës dhe përcaktimi i caqeve

Një seminar dy ditor me pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit të Planifikimit Strategjik është mbajtur më datën 29 dhe 30 shtator 2014. Në ditën e parë, është kryer analiza SWOT, bazuar në të dhënat dhe informatat në dispozicion, duke përfshirë rishikimin e kryer nga Projekti. Në ditën e dytë, pjesëmarrësit diskutuan strategjitë për t'i shfrytëzuar sukseset, tejkaluar dobësitë, përfituar nga mundësitë dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet. Më vonë, fokusi është zhvendosur në përcaktimin e objektivave të Strategjisë, dhe përcaktimin e aktiviteteve që çojnë në arritjen e tyre. Punëtorja është facilituar nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë.

Faza e tretë: Konsultime shtesë mbi ndarjen e përgjegjësi

Pjesëmarrja në Punëtorinë Planifikimit nuk ishte e kënaqshme dhe rezultoi me përfaqësimin e pabarabartë të palëve të ndryshme, veçanërisht Inspeksionit të Arsimit dhe DKA-ve. Prandaj, ishte e nevojshme për të zhvilluar konsultime shtesë mbi ndarjen e parashikuar të përgjegjësi për sigurimin e cilësisë, para se Ekipi redaktues të ishte në gjendje të vazhdojë me draftin e parë. Për këtë qëllim, është

hartuar një dokument diskutimi me skenarë dhe është diskutuar në takimin e Grupit Punues të mbajtur më 11 nëntor 2014. Gjithashtu, në këtë mbledhje, është dakorduar struktura e dokumentit.

#### Faza e katërt: Drafti i parë i Strategjisë së SC-së

Pas Seminarit të Planifikimit të Strategjisë dhe konsultimeve shtesë, Ekipi redaktues ka hartuar draftin e parë të Strategjisë së SC-së. Tri pjesët kryesore të këtij dokumenti janë 1) Hyrje; 2) Analizë e situatës bazuar në shqyrtimet ekzistuese dhe analizës SWOT; 3) Objektivat dhe aktivitetet me një përshkrim të detajuar të këtyre të fundit, duke ofruar zgjidhje të përshtatshme për kontekstin e Kosovës dhe në bazë të dokumenteve ekzistuese strategjike, kontributeve nga Punëtorja dhe praktikave më të mira nga vendet e tjera.

#### Faza e pestë : Diskutimi i draftit të parë të Strategjisë së SC-së

Fillimisht, draft dokumenti është diskutuar në kuadër të Grupit Punues dhe MASHT-it. Më 12 dhjetor 2014 është organizuar një punëtori njëditore për diskutim me pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit të Planifikimit, DKA-ve, ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve relevante. Objektivi i saj ka qenë mbledhja e informacioneve kthyesë fillestare nga të gjithë aktorët relevant për të marrë vendim përkatës mbi drejtimet strategjike.

#### Faza e gjashtë: Udhëtimi studimor në Austri

Në fund të janarit të vitit 2015, projekti ka organizuar një udhëtim studimor në Austri për anëtarët e Grupit Punues për të mësuar nga përvoja austriake në sigurimin e cilësisë, me fokus të veçantë në zgjidhjet e transferueshme në kontekstin e Kosovës dhe në përputhje me orientimet e para të Strategjisë së SC-së në Kosovë. Programi përbëhej nga vizita në terren, diskutime me ekspertë austriakë në zgjidhjen e aplikueshme në Kosovë dhe seanca të brendshme reflektimi të Grupit punues.

#### Faza e shtatë : Drafti i dytë i Strategjisë së SC-së

Më 11 mars dhe 23 prill 2015 u organizuan një punëtori gjysmëditore për të shqyrtuar draftin e dytë të Strategjisë së SC-së. Në bazë të diskutimeve dhe rezultateve nga vizita studimore, anëtarët e Grupit punues rishikuan objektivat dhe aktivitetet e Strategjisë për të vazhduar me shqyrtimin e planit të zbatimit dhe buxhetit.

Pas punëtorisë, ekipi redaktues vazhdoi të punojë në draftin e tretë të Strategjisë.

#### Faza e tetë : Diskutim publik i draftit të Strategjisë së SC-së

Strategjia e Kosovës për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ju prezantua Kabinetit të Ministrit, si dhe drejtorëve komunalë të arsimit për vërejtje eventuale.

#### Faza e nëntë: Versioni përfundimtar dhe miratimi

Pas diskutimit publik, u hartua versioni përfundimtar i dokumentit të strategjisë, i plotësuar me planin e veprimit dhe udhërrëfyesin, i cili, në fund të korrikut të vitit 2015, u dorëzua për miratim në MASHT.



## 2. Analiza e gjendjes

### 2.1. Hyrje

Analiza e gjendjes së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, e paraqitur këtu, është e bazuar në të dhënat e pakta në dispozicion nga disa studime dhe punëtorja ku u realizua SWOT analiza, që u mbajt më 29 dhe 30 shtator 2014. Edhe pse ideja ishte që Ekipi 30- anëtarësh për Planifikimin e Strategjisë të merr pjesë në punëtori, pjesëmarrja nuk ishte shumë e mirë, dhe kjo ka ndikuar në cilësinë e analizës SWOT. Me një konsensus të gjerë, u vendos që analiza SWOT të fokusohet në pesë fusha:

Mekanizmat e Sigurimit të Cilësisë  
Planifikimi Zhvillimor i Shkollës  
Ngritja e Kapaciteteve  
Vetëdijesimi  
Financimi

Fillimisht, "Ndarja e përgjegjësive" është konsideruar si fushë e veçantë, por, më vonë, u vendos që të bashkohet me fushën "Mekanizmat e Sigurimit të Cilësisë". Analiza SWOT ka treguar shkallë të lartë të gatishmërisë në mesin e pjesëmarrësve të seminarit për të identifikuar dobësitë ekzistuese dhe për të analizuar në mënyrë konstruktive arsyet pas tyre. Sukseset e arritura deri më tani janë pranuar dhe janë analizuar mundësitë për qëndrueshmëri. Gjithashtu, janë analizuar faktorët e jashtëm të ndërlidhur me të ardhmen - mundësitë dhe rreziqet.

### 2.2. Mekanizmat e Sigurimit të Cilësisë

Në aspektin e cilësisë, nuk ka konsensus lidhur me atë se çka është arsim 'i mirë'. Cilësia kuptohet në aspektin e masave sasiore (inputeve) në vend se në drejtim të rezultateve. Kjo pikëpamje e ngushtë e cilësisë është një pengesë e madhe për të ndryshuar në mësimdhënie, nxënie dhe vlerësim në veçanti.

Një nga çështjet kryesore në Sistemin Parauniversitar të Kosovës është mungesa e mekanizmave efektive për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet. Përderisa Inspeksioni i Arsimit ka të drejtë të merret me çështjet administrative (Ligji, 2004) dhe komunat mbajnë përgjegjësi formale për sigurimin e cilësisë, në realitet ekziston një konfuzion mbi ndarjen e përgjegjësive mes autoriteteve qendrore dhe lokale. Kjo shpesh shkakton perceptime të ndryshme të Inspeksionit të Arsimit dhe DKA-ve në rolet e tyre përkatëse që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë. Një pjesë të përgjegjësisë për sigurimin e cilësisë e ka edhe niveli shkollor.

Nga ana tjetër, mekanizmat në nivel shkollor janë jo-ekzistues ose, në rastin më të mirë, jo-funksionalë. Mungesa e menaxhmentit të nivelit të mesëm në

#### Sfidat kryesore:

- Ndarja e përgjegjësive ndërmjet nivelit qendror dhe komunal
- Licencimi i mësimdhënësve
- Vlerësimi më bazë në shkollë
- Mekanizmat jofunksionues të sigurimit të cilësisë në nivel shkollor
- Integriteti i mekanizmave të sigurimit të cilësisë

shkolla në formë të funksionimit të mirë të aktiveve profesionale , është identifikuar si një nga pengesat kryesore të sigurimit të brendshëm të cilësisë (AKK, 2013). Në arsimin profesional ekziston një përvojë modeste e vetëvlerësimit të shkollës, e cila shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm.

Qeveria ende ndjek politikat e pagave në bazë të kualifikimeve para shërbimit në vend se të bëjë këtë në bazë të performancës. Një qasje e tillë është shkaktar i rëndësishëm për mos-zbatimin e sistemit të licencimit të mësimdhënësve si një segment i rëndësishëm i sistemit të SC-së. Sistemi, i cili është tashmë ekziston, jep licencë të përkohshme dhe licencë të rregullt mësimdhënësve (MASHT-it, 2014b). Ata me licenca të përkohshme (rreth 14 për qind mësimdhënësve të tanishëm që janë fillestarë) do të duhet të plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe trajnimit për të marrë një licencë të rregullt ose rrezikojnë të humbasin të drejtën për të dhënë mësim. Në të njëjtën kohë, mësimdhënësit me licencë të rregullt mund të promovohen përmes pesë niveleve të karrierës. Mësimdhënësit duhet të ndjekin trajnim dhe të marrin, të paktën një vlerësim pozitiv të performancës në një periudhë prej pesë vjetësh, për të lëvizur nga një shkallë në tjetrën. Performanca e mësimdhënësve duhet të vlerësohet përmes rolit dominues të Inspeksionit të Arsimit (që konfirmon avancimin e mësimdhënësve, ulë në gradë, ose zgjat periudhën në skemën e licencimit), që paraqet sfidë të madhe për shkak të kapacitetit të kufizuar të këtij organi. Po ashtu, paraqitet pyetja e kompetencës së niveleve të tjera për të bërë vlerësimin e performancës

Edhe pse Inspeksioni i Arsimit bën vizita në shkolla dhe të dhënat mbi performancën e nxënësve në testet kombëtare janë në dispozicion, nuk ka sistem të vlerësimit të performancës së shkollës, i cili mund të zbulojë pikat e forta dhe të dobëta në çdo shkollë dhe të çojë në një veprim korrigjues. Gjithashtu, jo të gjitha shkollat ofrojnë shërbime këshillimore për mësimdhënësit përmes pedagogëve dhe psikologëve gjë që kufizon mundësitë për mësimdhënësit për të kërkuar këshilla profesionale, apo informacione kthyes.

Legjislacioni i ri për emërimin e drejtorëve të shkollave (MASHT, 2014c) kërkon që kandidatët të kenë marrë një nga programet e akredituara të menaxhimit shkollor, dhe, si i tillë, sjell më shumë transparencë në procesin e emërimit. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh faktin se pjesëmarrësit në programe të tilla janë kryesisht drejtorët ekzistues të shkollave, kjo kufizon mundësitë e mësimdhënësve aktualë të aplikojnë për pozicion të tillë. Për të lehtësuar zbatimin e Kornizës së re të Kurrikulës së Kosovës, MASHT-i planifikon ngritjen e grupeve të ekspertëve në nivel komunal për të mbështetur shkollat në këtë proces. Pritet që këto grupe të luajnë rol të rëndësishëm në aspekte të ndryshme të sigurimit të cilësisë. Një tjetër mundësi prej të cilës mund të përfitohet është tendenca për bartjen e përgjegjësive nga DKA-të në shkolla gjë që do të mund të forcojë rolin e tyre në sigurimin e cilësisë dhe madje edhe të shkaktojë zhvendosjen e fokusit të Inspeksionit të Arsimit nga mësimdhënësi individual drejt shkollës.

Përfshirja e mundshme e politikës ditore në çështjet e sigurimit të cilësisë gjithmonë paraqet një rrezik në kontekstin e Kosovës. Prandaj, është e nevojshme për të ngritur një sistem që ruan integritetin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë karshi ndikimi politik.

### ***2.3. Planifikimi Zhvillimor i Shkollës***

Ka ndërgjegjësim të ulët për sigurimin e cilësisë të shkollës, si tërësi, si një institucion i bazuar në këndvështrimin e përbashkët të personelit ndaj "shkollës së mirë dhe mësimdhënies/nxënies së mirë ". Gjithashtu, ekziston nevoja për procese të zhvillimit institucional të domosdoshme për të identifikuar prioritetet zhvillimore dhe për të reflektuar rregullisht mbi arritjen e tyre - duke u fokusuar në detyrën thelbësore të çdo shkolle, d.m.th. organizimin e proceseve të mësimdhënies / të nxënies në mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues për të gjithë nxënësit.

"Plani zhvillimor i shkollës është potencialisht instrument për të nxitur zhvillimin e cilësisë institucionale. Megjithatë, Planet zhvillimore të shkollave (PZHSH) aktualisht kanë përqendrim të fuqishëm në përmirësimin e infrastrukturës, pajisjeve dhe objekteve shkollore dhe materialet mësimore." (Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02, 2014)

Shkollat në Kosovë nuk janë të detyruara të kenë planet zhvillimore, me përjashtim të Qendrave të Kompetencës. Megjithatë, ka programe për planifikimin e zhvillimit të shkollës dhe formatet e miratuara nga MASHT-i. Një format i tillë është zhvilluar nga GIZ –i , Programi I Ngritjes së Kapaciteteve për Arsimin Bazik (NKAB) , ndërsa një tjetër nga ana e projektit të Granteve Zhvillimore të Shkollave i Bankës Botërore . Të dyja metodat promovojnë planifikimin me pjesëmarrje, bazuar në analizën e situatës aktuale dhe identifikimin e prioriteteve për një periudhë 3-vjeçare. Analiza jonë SWOT tregon se cilësia e planeve zhvillimore të shkollës, kur ato ekzistojnë, nuk është në nivelin e kënaqshëm, dhe ato shpesh kopjohen nga shkollat e tjera. Fokusi kryesor i planeve zhvillimore të shkollave qëndron në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, përkatësisht në aspekte të cilat varen nga financimet e jashtme (komunat, donatorët, komuniteti). Fokusi nuk vihet në atë që shkollat do të mund të bënin në kushtet e dhëna për të përmirësuar cilësinë e funksionit të tyre kryesor, pra përmirësimin e proceseve të mësimdhënies dhe të nxënies. Gjithashtu, shkollat nuk janë të detyruara të ndjekin planin që kanë hartuar, ndërsa aranzhimet monitoruese zakonisht nuk funksionojnë. Një problem i madh është që planifikimi zhvillimor i shkollës nuk është i koordinuar me politikat kombëtare dhe lokale të arsimit.

Formalizmi i tillë në planifikimin zhvillimor të shkollës përbën një rrezik që planet zhvillimore të shkollave mund të konsiderohen si aplikacione për burime shtesë në vend të një instrumenti shkollor të bazuar në sigurimin e cilësisë me fokus në ato veprime të cilat shkolla mund / duhet t'i ndërmarrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ajo ofron. Në anën tjetër, planifikimi zhvillimor i shkollës shihet si një mjet i rëndësishëm i SC-së , meqë "kultura e cilësisë" në nivel të shkollës është parakusht për zhvillimin efektiv të cilësisë, veçanërisht në kuadër të autonomisë më të madhe të shkollës dhe përqendrimit më të fortë në rezultate. Po ashtu, planifikimi zhvillimor i shkollës, si instrument për zhvillimin e cilësisë me bazë në shkollë, mund të shërbejë si bazë për monitorimin e shkollës dhe vlerësimin e punës. Për më tepër, një numër i komunave në Kosovë kanë planet e tyre afatmesme të zhvillimit të arsimit. Zgjerimi i iniciativave të tilla në komunat tjera do të krijonte kushte për shfrytëzimin e planeve zhvillimore të shkollave për hartimin e planeve zhvillimore komunale të arsimit, duke siguruar kështu një ekuilibër më të mirë midis nevojave për zhvillim shkollor dhe prioriteteve lokale. Planet zhvillimore komunale të arsimit që reflektojnë prioritetet për zhvillimin e cilësisë në shkolla dhe në komuna do t'i ofronin MASHT-it informata të rëndësishme për gjendjen e zhvillimit të cilësisë në vend, po ashtu në raport me implementimin e reformave qëndroi të arsimit, siç është, për shembull, KKK.

#### **Sfidat kryesore:**

Cilësia e planeve zhvillimore ekzistuese të shkollave

Zbatimi dhe monitorimi i planeve zhvillimore të shkollave

Formalizmi në planifikimet zhvillimore të shkollave

Rreshtimi i prioriteteve të shkollës me ato lokale dhe kombëtare

## **2.4. Ngritja e kapaciteteve**

Problemet kryesore të sigurimit të cilësisë janë të lidhura me kapacitetin e ulët për të siguruar cilësinë në të gjitha nivelet. Siç tregohet më sipër, roli kryesor i Inspeksionit të Arsimit, i cili është institucion i nivelit qendror i ngarkuar me sigurimin e cilësisë, duhet të merret me çështjet administrative në kuadër

të sistemit të arsimit. Me 57 inspektorë që mbulojnë territorin e Kosovës dhe specializohen në fusha të ndryshme, Inspeksioni i Arsimit është në nevojë për zhvillimin e kapaciteteve për të ushtruar rolin e tij në sigurimin e cilësisë së arsimit, si në aspektin e strukturës së stafit dhe numrave të tij, si dhe gatishmërinë e tyre për rolin e ri.

Në anën tjetër, kapaciteti i komunave për të ndikuar në cilësinë e arsimit është, në shumicën e rasteve, i reduktuar në pagesën e shpenzimeve të shërbimeve, pavarësisht nga prania e tyre e detyrueshme në këshillat e shkollave dhe roli i tyre në formimin e një pjese të kurrikulës. Ata kanë nevojë për forcimin e kapaciteteve të tyre profesionale për të adresuar çështjet e arsimit. Po kështu, shkollat si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve, duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të siguruar mësim të mirë duke bërë marrëveshje për të mbështetur zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, dhe ofrimin e monitorimit të cilësisë së procesit të mësimitdhënies/nxënies.

#### **Sfidat kryesore:**

- Kapaciteti i Inspeksionit të Arsimit t'u marrë me çështjet e sigurimit të cilësisë në mbarë vendin
- Kapaciteti profesional i komunave për të adresuar çështjet e
- Kapaciteti i shkollave për të siguruar mësim të mirë
- Emërimi idrejtorëve të shkollave

Mbështetja e donatorëve në ndërtimin e kapaciteteve në kuadër të sistemit të arsimit shihet si mundësi që mund të përdoret për të ngritur një sistem shumështrësor, funksional të sigurimit të cilësisë në vend. Zhvillimi i Kapaciteteve për Arsim Themelor, financuar nga GIZ-I (ZHKATH), USAID financoi Programi Bazik Arsimor, financuar nga USAID-i, dhe një ndërmarrje e përbashkët e donatorëve të mëdhenj ndërkombëtare, të kanalizuar përmes Fondit të Grumbulluar, kanë kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e arsimit në të gjitha nivelet. Korniza për Zhvillimin Profesional me bazë në Shkollë është dokument i hartuar nga programi BEP, ku definohet roli i aktiveve shkollore në këtë fushë, por nuk është aprovuar zyrtarisht. Programe të tilla si dhe Projekti i Binjakëzimit mund të ofrojnë mbështetje të mëtijshme në mënyrë specifike të fokusuar në sigurimin e cilësisë dhe rolin mbarëkombëtar jashtë Sigurimit të Cilësisë me bazë në shkollë. Një rrezik i madh për ngritjen e kapaciteteve janë emërimet politike të drejtorëve të shkollave dhe nëpunësve civilë. Me rregulloren e fundit të MASHT-it, rekrutimi i drejtorëve të shkollave është bërë më i bazuar në merita, meqë nga kandidatët kërkohet që të kenë ndjekur një nga programet e kualifikimit, e njohur nga MASHT-i, megjithatë, vendimi ende mbetet tek kryetarët e komunave, dhe, në shumë raste, varet nga preferencat politike.

## **2.5. Vetëdijesimi**

Në përgjithësi, ka një ndërgjegjësim të ulët lidhur me nevojën për të siguruar cilësinë e ofrimit të arsimit pasi që ka pak dëshmi të cilësisë së dobët të ofrimit të arsimit dhe rezultateve të tij. Përderisa cilësia e mësimitdhënies në shkolla nuk mund të gjykohej për sa kohë që nuk ka mekanizma të sigurimit të cilësisë në vend që fokusohen në këtë aspekt, p.sh. vlerësimi i efikasitetit të performancës së mësimitdhënies nga drejtori i shkollës, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve nga inspeksioni i arsimit me fokus pedagogjik, pamundësia për të nxjerrë konkluzione në lidhje me rezultatet e arsimit gjithashtu mund t'i atribuohet defekteve serioze në Sistemin e Vlerësimit Kombëtar.

Vlerësimet e jashtme të organizuara nga MASHT-i për nxënësit e klasës së fundit të arsimit të detyrueshëm (Testi i Arritshmërisë) dhe të arsimit të mesëm të lartë (Provimi i Maturës) janë kritikuar gjerësisht për administrimin e dobët dhe mungesë informacioni kthyes në shkolla. Tabela 1 ofron një pasqyrë të shkallës së kalueshmërisë nëpër vite që tregojnë nivele të konsiderueshme të mospërputhjes, e

që, thjeshtë, u atribuohen administrimit të dobët. Pavarësisht kësaj, shkalla e ulët e kalueshmërisë dhe arritja e ulët e nxënësve në provimin e maturës tregojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

**Tabela 1. Shkalla e kalueshmërisë në provimin e maturës**

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shkalla e kalueshmërisë	44.7%	45.7%	64.3%	42%	52.9%	74.5%	52.5%

(Burimi: MASHT Arkivi i lajmeve - <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=82>)

Rezultatet fillestare të testit të bazuar në mostër të Klasës së pestë (5) I bërë në 2010 si një para-lajmëruese e hyrjes së Kosovës në PISA 2015, sugjerojnë dallime të mëdha në mes të vajzave dhe djemve (sidomos në testin e gjuhës) dhe nxënësve në pjesët rurale dhe urbane. Edhe pse krahasimi ndërkombëtar nuk do të jetë i mundur deri në vitin 2015, kur Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të jetë në dispozicion, rezultatet e përgjithshme tregojnë dallime të konsiderueshme të komunave, duke bërë thirrje për veprim me qëllim të zbutjes dhe zvogëlimit të këtyre dallimeve. (Grupi i Bankës Botërore, 2014)

Këta dy shembuj tregojnë se ekzistojnë çështje të mëdha që lidhen me cilësinë e arsimit në Kosovë që nuk janë në fokusin e vëmendjes publike. Në përgjithësi, lidhjet e përgjegjshmërisë së munguar ose keqfunksionimit janë ato që ndikojnë negativisht në rezultatet e arsimit. Kjo veçanërisht vlen për sigurimin e cilësisë e cila është një ndërmarrje e shumë niveleve.

Së pari, pjesëmarrja e prindërve është një parakusht për rritjen e përgjegjshmërisë dhe rëndësinë e proceseve arsimore. Prindërit në Kosovë nuk kanë as mendësi, as mekanizma të duhur për të ndikuar proceset më të gjera arsimore; shqetësimi i tyre mbetet arritja e fëmijës/fëmijëve së/të vet dhe kur janë të pakënaqur me rezultatet e arsimit, ata mbështeten në mekanizmin individual mbrojtës (d.m.th. duke lëvizur fëmijën në një shkollë tjetër). Është e zakonshme që prindërit të marrin informacion në lidhje me ecurinë e fëmijës së tyre, por nuk ka informacion mbi performancën e shkollës. Gjithashtu, prindërit në Kosovë kanë shumë pak informacion për kurrikulën e re të bazuar në kompetenca që do të fillojë në të gjitha shkollat shumë shpejtë.

#### **Sfidat kryesore:**

Ndërgjegjësimi për nevojën për të siguruar cilësinë

Lidhjet e munguara ose keqfunksionimi i llogaridhënies

Gatishmëria për të marrë pjesë në debatet publike mbi arsimin

Informacion për Kornizën e Kurrikulës së re të Kosovës

Ligjërisht, shkollat u përgjigjen komunave, por, pasi që ato nuk janë të obliguara të kenë planet zhvillimore të shkollës, dhe as nuk ka mekanizma për vlerësimin e tërë performancës së shkollës, linjat e llogaridhënies janë mjaft të holla. Në përgjithësi, qytetarët, nuk i mbajnë komunat përgjegjëse për performancën e dobët të shkollave lokale.

Debatet mbi cilësinë e arsimit mund të rrjedhin nga krahasimi i rezultateve në testet kombëtare nëpër vite, dhe nga përpjekjet e fundit të MASHT-it për të përmirësuar administrimin e testit. Gjithashtu,

pjesëmarrja e Kosovës në PISA 2015 do të ofrojë mundësinë për tu krahasuar me vendet e tjera të botës.


Me gjithë faktin se punohet në sigurimin e cilësisë së kurrikulit të ti në fazën e pilotimit, publiku nuk ka informacion për punën që bëhet në këtë drejtim.

## 2.6. Financimi

Sipas Bankës Botërore (2014), shpenzimet publike në arsim janë rritur në mënyrë domethënëse, nga 3.3 për qind të e PBB-së në vitin 2007 në 4.1 për qind në vitin 2012. Pavarësisht nga kjo rritje, Kosova ende shpenzon më pak se mesatarja e EAQ (4.6 për qind) apo mesatarja e vendit me të ardhura të mesme të larta (5 për qind). Në mesin e vendeve të Evropës Juglindore, Kosova shpenzon më shumë se Shqipëria (3.3 për qind) dhe Maqedonia (3.5 për qind), por me pak se Kroacia (4.4 për qind) dhe Serbia (4.7 për qind). Vendet me popullsi më të re, të tilla si Kosova, kanë tendencë për të shpenzuar më shumë në arsim si përqindje e shpenzimeve totale publike se sa ato me popullsi të vjetër. Kosova shpenzon rreth 14 për qind të shpenzimeve totale publike (SHTP) në arsim. Kjo e vë Kosovën në linjë me vendet e tjera me të ardhura të mesme me profile të ngjashme të moshës.

Shpenzimi në arsimin parauniversitar për kokë nxënësi nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm është vetëm 13 për qind e të ardhurave për kokë banori, më i ulët se mesatarja e vendeve me të ardhura të mesme të larta , të cilat janë në 16.2 dhe 17. 8 për qind, respektivisht. Kjo zbrazëti është më e lartë akoma, kur krahasohet me mesataren e vendeve të BE-së për arsimin fillor dhe të mesëm, siç tregohet në figurën 1 (Banka Botërore, 2014).

Figura 1. Shpenzimet publike për nxënës si % e GDP për kokë banori (2011 apo i fundit)



"Shpenzimet për paga në kuadër të buxhetit të arsimit janë rritur me mbi 25 për qind në terma realë ndërmjet 2009 dhe 2012, duke bërë që pagat të jenë prej 85 për qind të shpenzimeve totale për arsimin bazik (klasat 0-9) në vitin 2009 në 92 për qind në vitin 2012. Në të njëjtën kohë, shpenzimet për të gjitha kategoritë tjera kanë rënë. Shpenzimet kapitale janë zvogëluar për më shumë se 60 për qind në terma realë, duke rënë nga 8 në 3 për qind të totalit. Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë mbetur konstante në terma nominale, por kanë rënë prej 6 në 5 për qind të totalit. Shpenzimet operative, jo për paga, ishin të ulëta në 2012 në krahasim me vendet e OBEZH ose të rajonit. Mesatarisht, vendet e OBEZH kanë shpenzuar 22 për qind të buxhetit të arsimit në shpenzime operative, jo-paga, dhe rreth 8,7 për qind për shpenzimet kapitale. Në Evropë, Sllovenia ka shpenzuar 19 për qind të shpenzimeve totale për qëllime operative, jo-paga, dhe 8 për qind për shpenzimet kapitale, ndërsa Bullgaria dhe Rumania kanë shpenzuar 26 për qind për shpenzime operative, jo paga, dhe 6 dhe 4 për qind për shpenzime kapitale "(World Bank, 2014)

Me strukturë të tillë të shpenzimeve, është e vështirë të ndahen fonde shtesë për sigurimin e cilësisë në nivel shkolle, por duke pasur parasysh rritjen e konsiderueshme në pagat e mësuesve, është e mundur për të vënë kërkesa shtesë për përfshirje në proceset e sigurimit të cilësisë.

### 3. Qëllimi dhe objektivat strategjike

Një nga shumë pak studime krahasuese mbi sistemet e sigurimit të cilësisë në shtatë vende të Evropës Juglindore arrin në përfundimin se "cilësia e arsimit në rajon nuk mund të kërcënohet nga mungesa e burimeve", por nga "disa rregullime të tjera të qeverisjes, siç janë lidhjet e munguara apo lidhjet e mosfunksionimit të llogaridhënies" (Murafa, 2013). Më tej, autorët argumentojnë se "shkollat veprojnë si agjenci implementuese të politikave të mandatuara nga niveli qendror i shtetit, me qeverinë qendrore që merr përgjegjësinë e plotë për sigurimin e cilësisë në arsim".

Bazuar në gjetjet e shumta të shtatë raporteve shtetërore, autorët dalin me rekomandime të përbashkëta të politikave për të gjitha vendet, tri prej tyre duke bërë thirrje për vëmendje të veçantë: 1) mbylljen e ciklit të Sistemit të Sigurimit të Cilësisë për të pasur llogaridhënie / pasoja reale të bazuara në performancë ; 2) forcimin e kapaciteteve të komunave për të adresuar çështjet e arsimit dhe të mos veprojnë thjesht si shpenzues të parave; 3) zhvillimi i mekanizmave për t'i ekspozuar aktorët në vlerësim objektiv të jashtëm . (Murafa, 2013)

**Qëllimi i kësaj strategjie është të prezantojë një Sistem të plotë të Sigurimit të Cilësisë në nënsektorin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit.**

Ofrimi i arsimit cilësor në nivelin parauniversitar është e vetmja mënyrë për të rritur mundësitë e nxënësve për arsimim të mëtejshëm dhe për punësim më të mirë. Cilësia në arsim është një çështje komplekse dhe është e lidhur edhe me qeverisjen dhe udhëheqjen, si dhe me infrastrukturën, përgatitjen dhe trajnimin e mësimitdhënësve, cilësisë së kurrikulave dhe teksteve shkollore. Prandaj, sigurimi i cilësisë është një ndërmarrje po aq komplekse e cila kërkon masa të shumta paralele për të trajtuar një shumëllojshmëri të aspekteve të lidhura me cilësinë.

Kjo strategji ka katër komponentë të ndryshme, të përfaqësuar përmes objektivave strategjike dhe masave të ndërlydhura me to:

Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë

- Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës
- Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim
- Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së
- Definimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA
- Funksionimi i Inspektoratit në aspektin juridiko-administrativ dhe pedagogjik-profesional
- Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve
- Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune

- Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor
- Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave
- Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë
- Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira

Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

- Ngritja e kapaciteteve të Inspektimit për përgjegjësitë e reja
- Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë
- Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë
- Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal
- Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor
- Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla

Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë

- Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare
- Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve
- Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë
- Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim
- Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë

Në vazhdim, janë dhënë përshkrimet e hollësishme.



## ***Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë***

Në përgjithësi, sigurimi i cilësisë në Kosovë është një përgjegjësi e përbashkët e tri subjekteve të ndryshme: 1) Inspektoratit të arsimit i cili funksionon në nivel qendror dhe përfaqëson interesat e Qeverisë dhe të përgjithshme të publikut, 2) Drejtoritë Komunale të Arsimit që menaxhojnë shkollat dhe janë përgjegjës ndaj komunitetit përkatës, dhe 3) Shkollat si ofrues të shërbimeve të drejtpërdrejta.

Duhet të theksohet se legjislacioni aktual nuk është i qartë në lidhje me ndarjen e përgjegjësiave në mesin e këtyre tri entiteteve. Për më tepër, Ligji për Inspeksionin e Arsimit, i vitit 2005, i jep këtij organi rol administrativ, në vend se t'i japë rol të ndërlidhur me SC-në. Në anën tjetër, komunat i zotërojnë shkollat dhe janë përgjegjës për funksionimin e tyre, prandaj ato janë përgjegjëse për të siguruar cilësinë gjithashtu. Shkollat janë shtylla më e rëndësishme e sigurimit të cilësisë, por nuk janë të fuqizuara për të kryer funksionet e tyre të SC-së .

Nga kjo perspektivë, disa skenarë për ndarjen e përgjegjësiave janë të mundshme, por më i qëndrueshmi doli të jetë se Sigurimi i Cilësisë (SC) është përgjegjësi e përbashkët e Inspeksionit të Arsimit dhe Drejtorive Komunale të Arsimit, ndërsa shkollat duhet të jenë të fuqizuara për të kryer funksionin e tyre të SC-së. Ideja e përgjithshme është se DKA-të duhet të mbështesin shkollat në baza ditore, ndërsa roli i Inspeksionit të Arsimit është për të bërë vlerësime periodike të jashtme institucionale dhe për të identifikuar fushat prioritare për përmirësim, të cilat u komunikohen shkollave dhe komunave, si dhe në një formë të përmbledhur në departamentet përkatëse në MASHT. Nga ana tjetër, shkollat duhet të kenë sisteme të brendshme të sigurimit të cilësisë dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tyre duhet të ndahen në mesin e stafit të shkollës.

### **Masat**

*Masa 1.1.* Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës

*Përshkrimi :* Vlerësimi i performancës së shkollës është një gur themel i rëndësishëm i një sistemi efektiv të sigurimit të cilësisë. Në hapin e parë, duhet të krijohet konsensus lidhur me atë se si përkufizohet një "shkollë e mirë" në Kosovë. Bazuar në një proces konsultimi me palët kryesore të interesit, fushat prioritare të cilësisë do të përcaktohen nga MASHT-i. Ky proces gjithashtu do të bazohet në fushat tashmë të përcaktuara, p.sh. në planin zhvillimor të shkollës, të përcaktuara në kuadër të projektit të financuar nga GIZ. MASHT-i do të zhvillojë një rregullore e cila përcakton qartë standardet e performancës shkollë dhe procedurat për vlerësimin e performancës së shkollës. Duke ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare, ky duhet të jetë sistem i cili parashikon një kombinim të vetë-vlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm. I pari do të realizohet nga vetë shkollat si pjesë e proceseve të vazhdueshme të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë me ndihmën e DKA-ve, ndërsa vlerësimi i jashtëm do të jetë detyrë e Inspeksionit të Arsimit. Po ashtu, duhet të hartohen instrumente për vlerësimin e performancës së Shkollës që do të shfrytëzohen nga të gjitha palët e përfshira në proces. Për këtë qëllim, duhet të hartohet edhe një doracak me kritere dhe tregues të qartë.

Vlerësimet formale të shkollave do të kryhen periodikisht, në 3 deri në 5 vjet, në varësi të nevojave dhe rrethanave, ndërsa rezultatet nga vlerësimet e performancës do të përdoren për përmirësimin e shkollës dhe për plotësimin e SC-së me bazë në shkollë. Në mënyrë që të kryejnë vlerësimet e jashtme institucionale, Inspektorati i Arsimit mund të kenë nevojë për të punësuar personel shtesë të specializuar në aspekte të ndryshme të përmirësimit të shkollës, ose të formojë ekupeve të ekspertëve kur

nevojiten për të kryer ato detyra.

*Masa 1.2.* Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim

*Përshkrimi :* Sigurimi efektiv i cilësisë me bazë në shkollë bazohet në reflektim të vazhdueshëm dhe proces të përmirësimit nga të gjithë anëtarët e shkollës dhe partnerëve të shkollës. Ndryshimi shihet si proces konstant, jo si veprim I vetëm. Për të krijuar një "kulturë të cilësisë", sigurimi i cilësisë me bazë në shkollë duhet të përfshijë të gjithë anëtarët e stafit dhe duhet të krijohet kuptim i përbashkët se ai është një instrument që mbështet punën e secilit në shkollë. Shumica e vendeve ndjekin ciklin e cilësisë "planifiko-bëje-kontrollo-vepro" të përshkruar edhe në Kornizën Evropiane të Referencës për Sigurimin e Cilësisë. Në fazën e "**planifikimit**" gjendja aktuale analizohet në bazë të fushave prioritare për zhvillimin e cilësisë, e identifikuar në shkallë kombëtare dhe prioritetet për ndryshim me identifikimin e treguesve të qartë se si të maten arrijtjet e tyre. Fokusi qëndron në qëllimet që mund të arrihen nga vet shkolla. Në fazën e "**veprimit**" zbatohet plani për zhvillimin e cilësisë. Procesi i zbatimit shoqërohet me fazën e "**kontrollimit**", d.m.th. procesi i vetëvlerësimit që jep informacione në ç' masë janë duke u arritur qëllimet e planifikuara. Bazuar në rezultatet e vetë-vlerësimit, plani i veprimit gjithnjë përshtatet dhe cikli I cilësisë fillon përsëri. Cikli i SC-së duhet të dokumentohet shumë qartë hap pas hapi - për të mirën e shkollës dhe në dobi të një monitorim apo vlerësim më të saktë nga jashtë (DKA ose Inspektorëve ...)

Menaxhimi i ciklit të cilësisë do të bëhet element thelbësor i sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë dhe si i tillë parim kryesor për planifikimin zhvillimor të shkollës. Ai shërben shkollat dhe organet mbështetëse apo monitoruese.

*Masa 1.3.* Fuqizimi i organeve të shkollës (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e SC-së

*Përshkrimi :* Për të mbështetur drejtorin e shkollës në rolin e tij / saj në sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë, duhet të emërohet një "koordinator i cilësisë". Detyra kryesore e koordinatorit të cilësisë do të ishte mbikëqyrja e implementimit të procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel shkolle dhe këshillimi I mësimdhënësve në këtë aspekt.

Aktivet profesionale ekzistojnë në shumicën e shkollave të Kosovës, të organizuar sipas fushave lëndore ose klasave. Megjithatë, në shumë raste, funksionimi i tyre është relativisht joformal dhe pa ndonjë ndikim të madh në cilësinë e mësimdhënies në shkollë.

Meqë aktivet shihen si organe profesionale që mund të promovojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe të mundësojnë shkëmbim të vazhdueshëm të përvojës ndërmjet tyre, ata duhet të bëhen plotësisht funksionale dhe të veprojnë si menaxhment i nivelit të mesëm në shkolla. Mendohet se me funksionalizimin e aktiveve profesionale në shkolla, praktikisht do të inaugurohet një mekanizëm që do të ndihmojë menaxhmentin e shkollës për të drejtuar proceset e zbatimit të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë. Koordinator i cilësisë do të punojë me aktivet profesionale dhe drejtorin në zbatimin e planit zhvillimor të shkollës. Sesionet konsultative gjithashtu mund të organizohen në kuadër të aktiveve që promovojnë metodat e mësimdhënies dhe të rezultojnë në artikullimin e qartë të kërkesave për mjetet e nevojshme mësimore.

*Masa 1.4.* Definimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA

*Përshkrimi :* Secila DKA do të emërojë një anëtar të stafit që do të jetë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në nivel të komunës. Detyrat e tij/saj do të jenë të bëj koordinimin e punës së koordinatorëve të cilësisë në shkolla.

Duke pasur parasysh mungesën e stafit dhe strukturës së tij të kualifikimit, DKA-të do të inkurajohen të ngrenë grupe profesionale në nivel komunal për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë. Këto grupe, të përbëra nga ekspertë të arsimit dhe njerëz të praktikës, do të ndihmojnë shkollat për të ngritur dhe zbatuar në mënyrë të efektshme sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë dhe të adresojnë çështje të ndryshme që lidhen me punën e tyre, si zhvillimin profesional të mësimit, zhvillimin e kurrikulës, përdorimin e teknologjisë së arsimit dhe kështu me radhë. Grupet do të ndihmojnë shkollat të adresojnë çështje të ndryshme të zbatimit duke filluar nga planifikimet e tyre zhvillimore të shkollës, si dhe rekomandimet nga monitorimi formal apo procesit të vlerësimit të performancës. Puna e grupeve profesionale në nivelin komunal do të koordinohet nga koordinatori i cilësisë i DKA.

Duhet përcaktuar kriteret për anëtarësi në këto grupe, ndërsa për komunat e vogla, duhet marrë në konsiderim edhe bashkimin e forcave dhe krijimin e grupeve të përbashkëta për disa komuna. Një mundësi tjetër është këmbimi i përvojave në mes të komunave të ndryshme.

*Masa 1.5.* Funkionimi i Inspektoratit në aspektin juridiko-administrativ dhe pedagogjik-profesional

*Përshkrimi :* Legjislacioni aktual i përshkruan rol administrativ Inspeksionit të Arsimit (duke përfshirë kontrollin e licencave të shkollave, regjistrimin e fëmijëve, regjistrat e klasës, kalendarin shkollor, inventarin shkollor, mjetet mësimore, realizimin e programit vjetor të punës së shkollës, pasjen (ekzistencën) e planit zhvillimor të shkollës, realizimin e programit mësimor, si dhe çështjet tjera që lidhen me aspektet juridike-profesionale dhe pedagogjike-administrative), dhe stafi i këtij organi bazohet në këtë supozim.

Qasja e re do të kërkonte që Inspeksioni i Arsimit që të merret me çështjet më specifike të ndërlidhura me arsim, siç është bërja e vlerësimeve periodike institucionale të jashtme dhe të identifikojnë fushat prioritare për përmirësim, të cilat u komunikohen shkollave dhe komunave, si dhe, në një formë të përmbledhur, departamenteve përkatëse në MASHT.

Para së gjithash, një qasje e tillë kërkon ndryshime në legjislacion, dhe gjithashtu një strukturë të re të personelit në Inspeksionin e Arsimit. Për sa i përket të parës, Inspeksioni i Arsimit duhet, në mënyrë të qartë, të ketë të drejtë për të realizuar rolet e tij të rinj, ndërsa për funksionin e tij administrativ, legjislacioni i ri duhet të aplikojë masa që kufizojnë përfshirjen e Inspektoratit të Arsimit në çështjet administrative në nivel minimal, duke mundësuar përdorimin më efikas të burimeve ekzistuese për të kryer rolin e ri dhe për të eliminuar dublimet mes monitorimit administrativ të kryer nga DKA-të dhe nga inspektorët e shkollave. Me qëllim të zbatimit të vlerësimit të

jashtëm efektiv të shkollave, udhëzime dhe procedura të qarta duhet të zhvillohen dhe t'u komunikohen të gjitha palëve relevante, në mënyrë që t'u ofrojnë vlerësime të jashtme efektive dhe transparente shkollave. Udhëzimet dhe procedurat për vlerësimin e jashtëm, për më tepër, duhet të jenë në përputhje me prioritetet e përcaktuara të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë për të mbështetur një proces të përgjithshëm koherent të zhvillimit të cilësisë.

*Masa 1.6.* Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve

*Përshkrimi :* Një skemë funksionale e karrierës është parakusht thelbësor për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, pasi ajo i motivon mësimdhënësit që të përmirësojnë vazhdimisht performancën e tyre dhe u ofron autoriteteve informacionin përkatës për cilësinë e ë mësimdhënies në shkolla. Sistemi aktual i licencimit të mësimdhënësve kërkon nga mësuesit për të marrë numër të caktuar të kredive nga programet e zhvillimit të mësimdhënësve që njihen nga Qeveria, dhe t'u nënshtrohen një procesi të vlerësimit të performancës për të marrë një nga katër llojet e licencës të rregullt: licencën e karrierës, licencën e avancuar; licencën e mësuesit mentor dhe licencën e mësuesit të merituar (MASHT, 2014b). Nga ana tjetër, procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve përbëhet nga vetëvlerësimi (10%), vlerësimi nga drejtori i shkollës (30%), dhe vlerësimi nga Inspektorati i Arsimit (60%), kjo e fundit e bazuar në monitorimin në klasë dhe vlerësimin e planifikimit mësimor. Deri tani, kapaciteti i kufizuar i Inspektoratit të Arsimit dhe politikat qeveritare të pagave kanë qenë pengesa kryesore për zbatimin e sistemit për licencimin e mësimdhënësve.

Në rast se sistemi i vlerësimit të performancës zbatohet sipas rregullores së tanishme, atëherë Inspeksionit të Arsimit, me më pak se 60 të punësuar në tërë Kosovën dhe nevojën për t'u marrë me një gamë të gjerë të çështjeve administrative (Ligji, 2004), do t'i duhen burime shtesë. Një mundësi do të jetë caktimi i inspektorëve për të kryer vlerësimin e jashtëm, licencimin dhe detyrat administrative-juridike. Një mundësi tjetër do të jetë angazhimi i ekspertëve ose delegimi i detyrave subjekteve publike ose private që specializojnë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Nga ana tjetër, një njësi e veçantë për vlerësimin e punës mund të themelohet në MASHT ose në Inspeksionin e Arsimit, dhe me personel në përputhje me rrethanat, por, dhe pas kësaj, ajo njësi mund të marrë vetëm rol administrativ dhe do të duhet të mbështetet në ekspertizën nga jashtë. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion, një tjetër opsion mund të jetë një ndryshim i sistemit aktual të licencimit të mësuesve, veçanërisht me që sigurimi i cilësisë efektive me bazë në shkollë së bashku me vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës do të sigurojë mjete shtesë për sigurimin e cilësisë së proceseve të mësimdhënies / nxënies. Pasi miratimit të rregullores, qeveria ka nevojë për të ndërtuar kapacitete për të menaxhuar vlerësimin e performancës së mësimdhënësve - në formën aktuale apo formën e përshtatur, duke përfshirë kapacitetin administrativ të MASHT-it apo të Inspektimit të Arsimit, dhe kapacitetin profesional të ekspertëve të jashtëm.

*Masa 1.7.* Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

*Përshkrimi :* Të dhënat nga monitorimi i arsimit, përfshirë të dhënat nga SMIA, si dhe të dhënat për vlerësimin e jashtëm të nxënësve, duhet të shfrytëzohen për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Për këtë arsye të dhënat nga burime të ndryshme duhet të organizohen dhe t'i raportohen shkollave dhe komunave në mënyrë që të mund të krahasohen dhe të ofrojnë shpjegime për fenomene të ndryshme lidhur me arsimin. Për shembull, të dhënat e testeve nga vlerësimi i jashtëm duhet të krahasohen, në nivel të shkollës dhe të komunës, me të dhënat për kualifikimin e mësimdhënësve, raportin mësimdhënës/nxënës, si dhe me të dhënat për gjendje sociale të nxënësve, me qëllim që të shpjegohen dallimet në performancë në mes të shkollave të ndryshme.

Sidoqoftë, një qasje e tillë kërkon ngritje domethënëse të vetëdijes së palëve me interes, si dhe mbështetje në interpretimin e të dhënave, p.sh. përmes formateve të reja të raportimit në nivel shkolle, komune dhe në nivelin qendror.

## ***Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune***

Në përgjithësi, planifikimi zhvillimor i shkollës paraqet hapin e parë në menaxhimin e punës e orientuar në cilësinë e shkollës. Në aspektin e politikave të përgjithshme të decentralizimit ai përpiket të përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin e menaxhimit të shkollave. **Qëllimi parësor i planifikimit zhvillimor të shkollës është përmirësimi i cilësisë e jo analiza e të gjitha nevojave dhe raportimi për progresin.** Me bartjen e vazhdueshme të përgjegjësive nga niveli qendror në komuna, dhe nga komunat tek shkollat, planifikimi zhvillimor i shkollës është një detyrë në nivel të çdo shkolle - e cila është një sfidë mjaft e madhe, por edhe një mundësi.

Hartimi i planit zhvillimor të shkollës është zemra e procesit të zhvillimit të shkollës. Ky koncept i zhvilluar bashkërisht përcakton objektivat pedagogjike të shkollës. Ky dokument strategjik zhvillohet në një proces me pjesëmarrje, duke përfshirë personelin e shkollës, Këshillin Drejtues të Shkollës dhe ndoshta përfaqësues të komunitetit dhe bizneseve lokale. Planet zhvillimore të shkollave, në bazë të ciklit të cilësisë, do të mbështesin krijimin e një "kulture të cilësisë" në shkollë, duke siguruar që shkollat të marrin përgjegjësi për cilësinë e shërbimeve që ato prodhojnë dhe të pajisen me veglat për të punuar vazhdimisht në përshtatjen e këtyre shërbimeve për ndryshimin nevojave të komuniteteve që ato shërbejnë.

Ngjashëm, planifikimi i zhvillimit të arsimit duhet gjithashtu të realizohet në nivelin komunal. Plani zhvillimor i arsimit komunal reflekton prioritetet komunale në fushën e arsimit dhe, nëse është e mundur, duhet të shërbejë si bazë për planifikimin e zhvillimit të shkollës. Në anën tjetër, ajo duhet të reflektojë nevojat e komuniteteve brenda shkollës në kuadër të komunës, kështu që pjesëmarrja e gjerë dhe përfaqësimi i drejtë i të gjitha grupeve të interesit është domosdoshmëri.

### **Masa**

*Masa 2.1.* Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor

*Përshkrimi :* Edhe pse planifikimi zhvillimor i shkollës nuk është i detyrueshëm në Kosovë, disa

formate të planifikimit janë zhvilluar dhe janë në përdorim. Të gjitha këto formate ndjekin ciklin standard të planifikimit që fillon nga analiza e situatës dhe vazhdon me përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve për një periudhë afatmesme. Këto procedura dhe instrumente duhet të rishikohen dhe të standardizohen për të reflektuar praktikën më të mirë të planifikimit zhvillimor të shkollës. Është me rëndësi të përcaktohen qartë fushat e cilësisë të cilat formojnë kornizën shtetërore të cilësisë për zhvillimin e shkollës dhe kjo mund të udhëheq analizën e situatës aktuale. Për shembull, formati i zhvilluar nga GIZ NKAB , përcakton tetë fusha të cilësisë, duke përfshirë qeverisjen e shkollës dhe menaxhimin, zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, infrastrukturën dhe kështu me radhë. Konsensus kombëtar i përgjithshëm duhet të arrihet lidhur me atë çfarë përbën një "shkollë të mirë" dhe cilat fusha kryesore të cilësisë duhet të adresohen në zhvillimin e cilësisë.

Fokusi i planifikimit zhvillimor të shkollës duhet të zhvendoset nga nevojat për përmirësimin e infrastrukturës në përqendrimin në hapat për përmirësimin e cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënies (kapitulli për ciklin e cilësisë), duke përfshirë edhe ndryshim nga ajo që shkolla pret nga të tjerët (DKA-të, donatorët) deri në çfarë shkollat mund të bëjnë vetë edhe duke pasur parasysh rrethanat shumë të vështira financiare. Cikli i cilësisë ofron qasje të zhvillimit të cilësisë me bazë shkollë gjë që mbështet këtë ndryshim. Kjo është përfshirë tashmë në PZH-në e shkollës që është përpiluar nga GIZ NKAB dhe duhet të pasurohet më tej.

MASHT-i, në bashkëpunim me DKA-të, do të formojë një grup pune për të rishikuar udhëzimet ekzistuese për planifikim zhvillimor të shkollës. Udhëzimet do të përmbliidhen në një formë të Udhëzimit Administrativ i cili do ta bëjë planin zhvillimor të detyrueshëm për të gjitha institucionet publike të arsimit parauniversitar në Kosovë. Po ashtu, një manual për sigurim efektiv të cilësisë me bazë në shkollë dhe një grup instrumentesh për të mbështetur shkollat në këtë proces do të hartohen nga MASHT-i për të mbështetur shkollat në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit të shkollave të cilat kanë fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë.

*Masa 2.2.* Monitorimi dhe mbështetja e zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave

*Përshkrimi :* Monitorimi dhe mbështetja e zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave është një nga detyrat që shumica e DKA-ve kryejnë vetëm pjesërisht, qoftë për shkak të mungesës së kapaciteteve apo mungesës së metodologjisë. Nga ana tjetër, fakti që shkolla është në varësi të plotë të DKA-ve, flet në favor të domosdoshmërisë të një monitorimi sistematik të planit të zhvillimit të shkollës (zhvillimi, implementimi, përdorimi i rezultateve të vetëvlerësimit/rishikimit për ciklin planifikues vijues), si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për shkolla për rritjen e sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë, përmes zbatimit më efektiv të planeve të tyre të zhvillimit shkollor.

Prandaj, planifikohet zhvillimi i kornizës monitoruese dhe mbështetëse, e cila do të shërbejë si metodologji dhe udhëzues praktik për kryerjen e këtij aktiviteti. Kjo kornizë monitorimi dhe mbështetëse do të përcaktojë qartë procedurat e monitorimit, instrumentet dhe natyrën e informacionit që duhet të mblidhet, të përpunohet dhe të raportohet. Po ashtu, ajo do të përcaktojë shërbimet mbështetëse të cilat janë të

nevojshme për të mbështetur shkollat në zbatimin efektiv të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë. Procesi i hartimit të platformës do të udhëhiqet nga Grupi punues, i themeluar nga MASHT-i, që do të mbështetet nga ekspertiza e jashtme. Në Grupin punues, përveç zyrtarëve komunalë, duhet gjithashtu të përfaqësohen zyrtarët e Inspektoratit të Arsimit në mënyrë që të sigurohet që monitorimi i kryer nga DKA-të jep informacionin e duhur për Inspektoratin e Arsimit në rrjedhën e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës. Po ashtu, duhet të identifikohen burimet në nivel komunal për mbështetjen e sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë, p.sh. duke shfrytëzuar koordinatore të suksesshëm të cilësisë në mënyrë që kolegët e tyre nga shkollat e tjera të mund të mësojnë nga përvoja e tyre. Për këtë arsye, do të formohen grupet profesionale në nivel të komunës. Për më tepër, kolegjiomet e DKA-ve nga disa komuna mund të shfrytëzohen për të ndarë ekspertizën dhe për t'i mbledhur fuqitë në përkrahje të sigurimit të cilësisë në shkollë. Ndërkaq, DKA-të e komunave më të vogla mund të formojnë rrjete të sigurimit të cilësisë ku do të mblihdeshin fuqi për ta përkrahur procesin në nivel shkolle.


DKA-të duhet të përcaktojnë stafin për monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të planeve të zhvillimit shkollor duke vënë fokus të qartë në forcimin e sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë.

*Masa 2.3.* Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë

*Përshkrimi :* Planet Zhvillimore Komunale të Arsimit duhet të jenë një linjë me planet shkollore në pajtim me fushat e cilësisë. Përveç kësaj, çdo plan komunal i arsimit duhet të reflektojë prioritetet e zhvillimit në kuadër të komunës, dhe si i tillë, të shërbejë si bazë për zhvillimin e ardhshëm të planeve shkollore. Për të lehtësuar procesin, MASHT do të hartojë një doracak për planifikimin e arsimit komunal, i cili mund të përdoren nga DKA-të për të zhvilluar planet komunale.

Planet zhvillimore komunale duhet t'i dorëzohen MASHT-it për të shërbyer për zhvillimin e politikave shtetërore, ndërsa rekomandimet nga vlerësimi i jashtëm i shkollave që bëhet nga Inspektorati i Arsimit duhet të shërbejnë për zhvillimin e planeve shkollore, siç tregohet në skemën e mëposhtme.

Një qasje për të siguruar koherencë në mes të politikave qeveritare, prioritetëve të komunës dhe nevojave të shkollës është përqendrimi i planeve zhvillimore në prioritetet zhvillimore të qarta (2 për një shkollë) me fokus të qartë në çështje pedagogjike. Në përkrahje të zbatimit të politikave shtetërore, MASHT dhe DKA-të duhet të arrijnë një marrëveshje se cili prioritet pedagogjik do të vendoset për të gjitha shkollat. Prioritetin e dytë do ta caktonte shkolla në marrëveshje me komunën përkatëse, duke synuar plotësimin e nevojave të veta në suaza të prioritetëve komunale.



#### Masa 2.4.

Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira

#### Përshkrimi :

Praktikat më të mira në planifikimin e zhvillimit të shkollës dhe zhvillimit të cilësisë me bazë në shkollë do të ndahen në nivel të komunës dhe përmes portalit të sigurimit të cilësisë të MASHT-it. Gjithashtu, shkollat do të inkurajohen që të publikojnë planet e tyre zhvillimore në ueb faqet e tyre. Në nivel komunal, përvoja e shkollave të cilat prijnë në sigurimin e cilësisë do të ndahen me shkollat e tjera. DKA-të do të përdorin rrjetin komunal të koordinatorëve të sigurimit të cilësisë, si edhe grupet profesionale, për të mbështetur shkollat në zhvillimin e cilësisë më bazë në shkollë. Konsultime kolegjiale dhe ndoshta edhe rishikime kolegjiale do të përdoren si instrumente për të mbështetur zhvillimin e cilësisë më bazë në shkollë.

### **Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet**

Krijimi i një sistemi të plotë të sigurimit të cilësisë kërkon ndryshime në legjislacion, dhe një ndarje të re të përgjegjëseve në mes të nivelit qendror, lokal dhe shkollor. Kjo duhet të shoqërohet me masa të ndërtimit të kapaciteteve të cilat përfshijnë zhvillimin profesional të personelit dhe stafit në arsim, Inspektoratit dhe DKA-ve si dhe përpjekje të konsiderueshme për zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet.

#### Masat

##### Masa 3.1.

Ngritja e kapaciteteve të Inspeksionit për përgjegjësitë e reja



*Përshkrimi :* Struktura aktuale e Inspeksionit të Arsimit i lejon këtij organi kombëtar që të kryejë detyrat e tij që kanë të bëjnë me rolin e tij juridik-administrativ dhe pedagogjik-profesional, siç parashihet me ligj. Pesëdhjetë e shtatë nëpunës të ndarë në shtatë zyra rajonale dhe zyra qendrore në Prishtinë janë përgjegjës për 42 institucione parashkollore, 989 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 116 shkolla të mesme të larta (MASHT, 2014). Kualifikimet e stafit jo gjithmonë përputhen me detyrat që kërkohen të kryhen nga ata.

Pasi të miratohet legjislacioni i ri, Inspeksioni i Arsimit duhet të hartojë rregullore të brendshme dhe udhëzues për kryerjen e detyrave të reja. Nga perspektiva e SC-së, roli kryesor i Inspeksionit të Arsimit do të jenë vlerësimet periodike të performancës së institucioneve arsimore.

Hapi tjetër në ndërtimin e kapaciteteve të Inspeksionit të Arsimit për përgjegjësitë e reja është që të rishikojë strukturën e personelit në këtë organ, si në aspektin e numrit ashtu edhe në aspektin kualifikimit të inspektorëve të shkollave. Prandaj, Inspeksioni i Arsimit do të duhet të dalë me një plan të ri të personelit dhe përshkrimet e vendeve të punës për nëpunësit e tij. Pasi që të bëhet organografi i Inspeksionit të Arsimit, duhet të bëhen përpjekje për trajnimin e inspektorëve të shkollës për të mbështetur ata në kryerjen e detyrave të tyre të reja. Gjithashtu, udhëzime transparente, procedura dhe instrumente për vlerësimin e jashtëm të shkollave duhet të zhvillohen dhe t'u komunikohen të gjitha shkollave.

*Masa 3.2.* Hartimi I doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë

*Përshkrimi :* Për të mbështetur aplikimin e menaxhimit të nivelit të mesëm në shkollat e Kosovës do të hartohet një udhëzues praktik për organizimin dhe funksionimin e departamenteve të shkollave. Doracaku do të vërë fokus të veçantë në rolin e aktiveve të shkollave në zbatimin efektiv të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë. Procesi do të karakterizohet me nivel të lartë të përfshirjes dhe do të udhëhiqet nga një grup pune i MASHT-it, i ndihmuar nga ekspertë të fushave. Doracaku do të jetë në dispozicion për të gjitha shkollat dhe mësimdhënësit në Kosovë, ndërsa DKA-të do të inkurajojnë përdorimin e tij.

Zhvillimi i udhëzuesit do të pasohet me aktivitete të informimit për aktivet e shkollës për të ndihmuar përdorimin e manualit në shkolla.

*Masa 3.3.* Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë

*Përshkrimi:* Me qëllim të përforcimit të sigurimit të cilësisë me bazë në shkollë dhe krijimin e një "kulture të cilësisë" në nivel shkolle, MASHT do të hartojë një doracak për sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë si dhe instrumentet përkatëse që bazohen në materialet tashmë ekzistuese, p.sh. Manual për SC-në me bazë në shkollë për shkollat profesionale. Materialet do të jenë në dispozicion në Platformën online të SC-së.

Do të zhvillohet një modul i veçantë trajnimi për stafin e DKA, drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla. Po ashtu, ky modul do të përfshihet në programin ekzistues të trajnimit për drejtorë të shkollave.

Në varësi nga kapaciteti i trajnimit dhe kapacitetit mbështetës në nivel komune, ofruesit e trajnimeve në nivel kombëtar do të duhet të zhvillojnë kapacitetet për ofrimin e zhvillimit profesional në këtë fushë.

*Masa 3.4.* Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal

*Përshkrimi :* Siç shpjegohet në masën 1.2, grupet profesionale në nivel komunal do të themelohen për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë. MASHT do të hartojë udhëzues për sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë si dhe instrumentet përkatëse për funksionimin e grupeve profesionale dhe rrjeteve të koordinatorëve për sigurimin e cilësisë, dhe, gjithashtu, do të sigurojë mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për këto grupe.

*Masa 3.5.* Trajnimi I përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikim zhvillimor

*Përshkrimi :* Programet ekzistuese për planifikim zhvillimor të shkollës do të plotësohen me komponentët për zbatimin e ciklit të cilësisë në zhvillimin e cilësisë dhe, gradualisht, do të zbatohen në të gjitha komunat dhe shkollat në Kosovë. Në çdo komunë do të trajnohet një numër i caktuar i zyrtarëve apo ekspertëve / profesionistëve të angazhuar nga DKA për të mbështetur shkollat. Në secilën shkollë, drejtorët dhe "koordinatori për cilësi " do të trajnohen në ngritjen e sistemeve efektive të zhvillimit të cilësisë me bazë në shkollë.

Përveç kësaj, do të zhvillohet program trajnimi për planifikimin e arsimit komunal dhe do t'u ofrohet zyrtarëve përgjegjës të DKA-ve.

Në nivel kombëtar, ofruesit përkatës të trajnimeve do të inkurajohen për të zhvilluar kapacitet trajnues që mund të plotësojë kërkesat e komunave dhe shkollave për trajnim. Komunat do të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e programeve të trajnimit, ndërsa MASHT-i do ta mbikëqyr procesin e trajnimit.

*Masa 3.6.* Zbatimi i sistemit të mentorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla

*Përshkrimi :* Aktualisht, nuk ka periudhë mbështetëse dhe vlerësuese (periudhë e induksionit) për mësimdhënësit e rinj në shkollat e Kosovës. Ky sistem duhet të futet në nivel shkolle. Çdo shkollë duhet të caktojë një mësimdhënësi me përvojë për të mentoruar një mësimdhënësi të ri që mban vetëm licencë të përkohshme. Kjo mund të menaxhohet me aktivitetet e shkollave pasi të bëhen plotësisht funksionale, dhe kërkon përshkrime të reja të punës për mësuesit në nivel kombëtar për të reflektuar detyrat e tyre të reja. Ky obligim rrjedh edhe nga UA aktual që obligon shkollën ta ndihmojë mësimdhënësin me licence të përkohshme.

## **Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë**

Një studim i realizuar nga Projekti i Binjakëzimit "Mbështetje Zbatimit të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016" konkludon:

"Duhet të ngritet vetëdija e përgjithshme për sigurimin gjithëpërfshirës të cilësisë së një shkolle, e bazuar në konsensusin e stafit se çfarë paraqet një "shkolle të mirë dhe mësimdhënie/nxënie të mirë", si dhe vetëdija për proceset e nevojshme të zhvillimi institucional për të identifikuar prioritetet zhvillimore dhe për të reflektuar rregullisht mbi arritjen e tyre - duke u fokusuar në detyrën thelbësore të çdo shkolle, d.m.th. organizimin e proceseve të mësimdhënies/nxënies në mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues për të gjithë nxënësit. Përderisa pajisjet shkollore dhe infrastruktura janë të rëndësishme së posaçme, është i nevojshëm një ndryshim në cilësinë së tashme të proceseve të mësimdhënies / nxënies." (Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02, 2014)

Gjithashtu, vetëdija për nevojën për të siguruar cilësinë e arsimit duhet të ngrihet në mesin e nxënësve, prindërve dhe publikut në përgjithësi. Një qasje e tillë krijon presion në shkolla, autoritetet lokale dhe qendrore për të punuar shumë në përmirësimin e cilësisë dhe për të siguruar rezultate më të mira mësimore.

### **Masa**

**Masa 4.1.** Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare

**Përshkrimi :** Për hir të transparencës, MASHT do të vë në dispozicion për publikun rezultatet e testeve kombëtare të ndara sipas fushave lëndore, komunave dhe shkollave, si dhe do të organizojë takime për mënyrën e interpretimit të këtyre rezultateve. Një masë e tillë do të bëjë profesionistët, prindërit, nxënësit dhe publiku i përgjithshëm të jenë të vetëdijshëm për performancën e sistemit të arsimit dhe institucioneve arsimore. E njëjta gjë vlen edhe për rezultatet e testeve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Kosova.

Kjo masë lidhet me masën 1.7 ("Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet") dhe implikon ndërtimin e kapacitetit për interpretimin e rezultateve të testeve kombëtare dhe të dhënave nga monitorimi i arsimit në nivele të ndryshme, si dhe për t'i bërë raportet më relevante për të gjithë shfrytëzuesit.

**Masa 4.2.** Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve

**Përshkrimi :** Shembuj të praktikave të mira që kanë të bëjnë me cilësinë e arsimit do të promovohen gjerësisht përmes Portalit të SC-së (masa 4.5), dhe do të ndahen me publikun e gjerë. Gjithashtu, MASHT dhe komunat do të inkurajojnë shkëmbimin e përvojës ndërmjet DKA-ve dhe shkollave mbi përvojat e tyre në lidhje me cilësinë e arsimit. Një proces i tillë nxitë edhe konkurrencën në mes të shkollave.

*Masa 4.3.* Informimi I prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë

*Përshkrimi :* Korniza e Kurrikulës së Kosovës është "e bazuar në kompetenca", dhe, si e tillë, organizohet rreth konceptit të pajisjes së fëmijëve me aftësitë e kërkuara, qëndrimet dhe njohuritë për të kryer detyrat që shoqëria dhe edukatorët i shohin si të nevojshme për kohën e tyre në shkollë dhe për pjesën tjetër të jetës së tyre si studentë, punonjës, anëtarë të familjes dhe si pjesë e shoqërisë së Kosovës. Qasja është mjaft unike në krahasim me kurrikulën e vjetër - derisa MASHT zhvillon kurrrikula bërthamë, programet mësimore zhvillohen nga shkolla, gjë që është përvojë e re për Kosovën.

Në rrethana të tilla, prindërit duhet të jenë të mirinformuar për zhvillimin e kurrikulës dhe zbatimin e saj , si dhe mënyrën për të mbështetur fëmijët e tyre në nxënie. Prandaj, MASHT-i ka disenjuar një fushatë informative e cila duhet të përshtatet me kontekstin meqë Kurrikula e re do të fillojë në të gjitha shkollat në vend.

Gjithashtu, prindërit duhet të informohen gjerësisht për masat e reja të sigurimit të cilësisë që do të prezantohen në linjë me këtë Strategji. Për këtë qëllim, MASHT do të zhvillojë materiale promovues dhe do të vë në veprim portalin e SC-së (Masa 4.5).

*Masa 4.4.* Promovimi I debateve publike për cilësinë e arsimit

*Përshkrimi :* MASHT-i dhe komunat do të inkurajojnë debat publik lidhur me atë që përbën cilësinë në arsim, d.m.th. çfarë pritet nga një "shkollë e mirë". Në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, MASHT do të organizojë një konferencë vjetore për cilësinë e arsimit ku shembuj të praktikës së mirë do të ndahen dhe çështjet e lidhura me temën diskutuar. Gjithashtu, MASHT-i dhe DKA-të do të marrin pjesë në debate që lidhen me cilësinë e arsimit, të iniciuara nga mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

Debate të tilla duhet të ketë edhe në nivel shkolle, pastaj edhe në nivel komune dhe në atë qendror.

*Masa 4.5.* Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë

*përshkrimi :* Një portal për Sigurimin e cilësisë do të ngrihet nga MASHT me qëllim të informimit të mësuesve, prindërve, nxënësve dhe publikut të përgjithshëm për aranzhimet e sigurimit të cilësisë, dhe do të ofrojë burime dhe instrumente për të mbështetur mekanizma të sigurimit të cilësisë në nivel qendror, lokal dhe shkollor. Portali do të mirëmbahet nga Inspeksioni i Arsimit dhe do të ofrojë mënyrë interaktive për të lehtësuar diskutimin mbi çështjet e sigurimit të cilësisë në sistemin e arsimit, por edhe do të ofrojë instrumente dhe mbështetje konkrete për ofruesit e arsimit.

## 4. Udhërrëfyeni për zbatimin e Strategjisë

Strategjia për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar përbëhet nga pesë komponenta që identifikohen me objektivat e prezantuara në kapitullin 3 të këtij dokumenti. Në vijim, për secilin objektivi janë përcaktuar treguesit (indiktorët) që duhet të arrihen deri në vitin 2020. Këta tregues janë ndarë në dy periudha: periudhën afatshkurtër 2016-2017 dhe periudhën afatmesme 2018-2020. Secili tregues është rezultat i realizimit të aktiviteteve të ndërlidhura me objektivin përkatës.


Tabela 1 jep zbrërthimin e objektivit 1 në hierarkinë logjike të masave, treguesve të ndarë në dy periudhat e lartpërmendura dhe rezultateve të pritshme. Rezultati është rrjedhojë e objektivit, treguesit paraqesin përshkrim të rezultatit, ndërkaq masat janë veprimet që ndërmerren për arritjen e treguesve.

Tabela 1. Zbrërthimi i objektivit 1 në rezultate, tregues dhe masa

<b>Objektivi 1:</b> Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë	
<b>Rezultati:</b> Ekzistojnë mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës të bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes të MASHT, DKA dhe shkollës	
<b>Treguesit</b>	
<b>2016-2017</b>	<b>2018-2020</b>
<p>T1.1. Kryhet vlerësimi i jashtëm i 350 shkollave</p> <p>T1.2. Përgatitet doracaku për menaxhimin e cilësisë në arsim</p> <p>T1.3. Në 350 institucione të arsimit parauniversitar emërohen koordinatorët për sigurimin e cilësisë dhe udhëheqësit e departamenteve</p> <p>T1.4. Në 21 komuna krijohen grupe profesionale për ofrim të mbështetjes shkollave</p> <p>T1.5. Inspektorati i Arsimit riorganizohet për të ushtruar funksionin e vlerësimit të jashtëm të shkollave dhe funksionet administrative-juridike të përcaktuara me ligj</p>	<p>T1.6. Çdo vit kryhet vlerësimi i jashtëm i 350 shkollave</p> <p>T1.7. Në 15 komuna e mbetura krijohen grupe profesionale për ofrim të mbështetjes shkollave</p> <p>T1.8. Në 350 institucione të mbetura të arsimit parauniversitar emërohen koordinatorët për sigurimin e cilësisë dhe udhëheqësit e departamenteve</p> <p>T1.9. Të dhënat nga monitorimi i arsimit u raportohen shkollave dhe komunave</p>
<b>Masat e Strategjisë</b>	
<p>1.1. Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës</p> <p>1.2. Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim</p> <p>1.3. Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së</p> <p>1.4. Definimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA</p> <p>1.5. Funksionimi i Inspektoratit në aspektin juridiko-administrativ dhe pedagogjik-profesional</p> <p>1.6. Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimeve</p> <p>1.7. Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet</p>	

Grafiku 1 pasqyron varësinë e treguesve nga masat e objektivit 1, por, në raste të caktuara, edhe nga masat e tre objektivave të tjerë. Në fakt, ky grafik tregon ndërlidhjen në mes të objektivave të ndryshëm të Strategjisë dhe bashkëveprimin në mes tyre.

Grafiku 1. Ndërlidhja në mes të treguesve të objektivit 1 dhe masave të Strategjisë



Tabelat 2-4 në vijim, ngjashëm si tabela 1, bëjnë zërbërthimin e objektivave 2-4 në rezultate, tregues dhe masa. Edhe këtu treguesit janë të ndarë në dy periudha kohore, sikur në rastin e objektivit 1. Ngjashëm, grafikët 2-4 kanë kuptim analog me grafikun 1.

Tabela 2. Zërbërthimi i objektivit 2 në rezultate, tregues dhe masa

<b>Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune</b>	
<b>Rezultati: Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë plane zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi</b>	
<b>Treguesit</b>	
<b>2016-2017</b>	<b>2018-2020</b>
T2.1. Publikohen udhëzuesit e rishikuar për planifikim zhvillimor të shkollës	T2.4. Komunat monitorojnë me rregull planet zhvillimore të shkollave dhe ofrojnë mbështetje për zbatimin e tyre
T2.2. Zhvillohet korniza monitoruese dhe mbështetëse për planifikimit zhvillimor të shkollës	T2.5. Komunat hartojnë plane zhvillimore të arsimit që janë në harmoni me planet e shkollave
T2.3. Hartohet doracaku për planifikimin zhvillimor të arsimit në nivel të komunës	T2.6. Bëhet ndarja e praktikave më të mira nga planifikimi zhvillimor, në nivel komune dhe përmes portalit për sigurimin e cilësisë

<b>Masat e Strategjisë</b>
2.1. Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor
2.2. Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave
2.3. Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë
2.4. Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira

Grafiku 2. Ndërlidhja në mes të treguesve të objektivit 1 dhe masave të Strategjisë




Tabela 3. Zbërthimi i objektivit 3 në rezultate, tregues dhe masa

<b>Objektivi 3:</b> Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet	
<b>Rezultati:</b> Ekzistojnë kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkolle	
<b>Treguesit</b>	
<b>2016-2017</b>	<b>2018-2020</b>
<p>T3.1. Inspektorët e arsimit mbarojnë me sukses trajnimet për ushtrimin e përgjegjësive të reja</p> <p>T3.2. Shkollat dhe DKA-të në gjysmën e komunave të Kosovës informohen për mënyrën e re të organizimit dhe funksionimit të aktiveve shkollore</p> <p>T3.3. Rreth 600 përfaqësues të shkollave dhe DKA-ve trajnohen për sigurimin e cilësisë</p> <p>T3.4. Aftësohen anëtarët e grupeve profesionale në nivel komune për ofrimin e mbështetjes shkollore</p> <p>T3.5. Rreth 1000 përfaqësues të shkollave dhe DKA-ve aftësohen për planifikim zhvillimor në nivel shkolle dhe komune</p>	<p>T3.6. Shkollat dhe DKA-të në të gjitha komunat e Kosovës informohen për mënyrën e re të organizimit dhe funksionimit të aktiveve shkollore</p> <p>T3.7. Çdo vit 900-1000 përfaqësues të shkollave dhe DKA-ve trajnohen për sigurimin e cilësisë</p> <p>T3.8. Grupet profesionale në nivel komune i ofrojnë mbështetje shkollore</p> <p>T3.9. Rreth 1300 përfaqësues të shkollave dhe DKA-ve aftësohen për planifikim zhvillimor në nivel shkolle dhe komune</p> <p>T3.9. Bëhet mentorimi i mësimdhënësve të rinj në të gjitha shkollat e Kosovës</p>
<b>Masat e Strategjisë</b>	
<p>3.1. Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit për përgjegjësitë e reja</p> <p>3.2. Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë</p> <p>3.3. Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë</p> <p>3.4. Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal</p> <p>3.5. Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor</p> <p>3.6. Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla</p>	



Grafiku 3. Ndërlidhja në mes të treguesve të objektivit 3 dhe masave të Strategjisë





Tabela 4. Zbërthimi i objektivit 4 në rezultate, tregues dhe masa

<b>Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë</b>	
<b>Rezultati: Profesionistët, politik bërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar</b>	
<b>Treguesit</b>	
<b>2016-2017</b>	<b>2018-2020</b>
T4.1. Vihet në përdorim softueri për raportimin e rezultateve të testeve kombëtare T4.2. Prindërit janë të informuar për aspektet relevante të sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar T4.3. Krijohet portali për sigurimin e cilësisë	T4.4. Profesionistët, politikbërësit dhe publiku i gjere shfrytëzojnë burime të ndryshme informacioni për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

<b>Masat e Strategjisë</b>
4.1. Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare
4.2. Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve
4.3. Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë
4.4. Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim
4.5. Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë

**Grafiku 4. Ndërlidhja në mes të treguesve të objektivit 4 dhe masave të Strategjisë**



## 5. Buxheti dhe plani i veprimit

Buxheti për zbatimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2016-2020 është rreth 8.2 milion euro dhe kalkuluar në bazë të parashikimit të shpenzimeve për zbatimin e masave të kësaj Strategjie, pavarësisht nga fakti nëse në Buxhetin e Kosovës janë parashikuar mjete për këtë qëllim ose jo. Tabela 5 jep përmbledhjen e këtij buxheti sipas viteve dhe komponentave të Strategjisë që përputhen me objektivat strategjike.

Tabela 5. Përmbledhja e buxhetit sipas viteve dhe objektivave strategjike

Komponenta	Buxheti					
	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
Mekanizmat për sigurimin e cilësisë	€ 452,600	€ 1,019,200	€ 1,554,700	€ 2,027,200	€ 2,474,700	€ 7,528,400
Planifikimi zhvillimor	€ 63,000	€ 0	€ 0	€ 0	€ 0	€ 63,000
Ngritja e kapaciteteve	€ 176,000	€ 166,700	€ 108,700	€ 61,500	€ 31,500	€ 544,400
Ngritja e vetëdijes	€ 50,500	€ 38,000	€ 3,000	€ 3,000	€ 3,000	€ 97,500
	<b>€ 742,100</b>	<b>€ 1,223,900</b>	<b>€ 1,666,400</b>	<b>€ 2,091,700</b>	<b>€ 2,509,200</b>	<b>€ 8,233,300</b>

Vërehet se kostoja më e madhe paraqitet tek objektivi strategjik 1 që ka të bëjë me mekanizmat për sigurimin e cilësisë. Në fakt, 86% e shumës prej € 7,528,400 janë paga për personelin që do të angazhohet për t'i funksionalizuar mekanizmat e sigurimit të cilësisë, qofshin ata në nivel shkolle ose në nivelin komunal.

Tabela 6 prezanton shpenzimet për zbatimin e Strategjisë të ndara në shpenzime zhvillimore dhe operative. Shpenzimet zhvillimore janë ato që bëhen brenda një periudhe të kufizuar kohore dhe kanë për qëllim krijimin e kushteve për zbatimin e Strategjisë, p.sh. ndërtimi i kapacitetit, hartimi i doracakëve, zhvillimi i softuerit, e të ngjashme. Ndërkaq, shpenzimet operative janë të pranishme edhe pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Strategjisë. Nga tabela shihet se rreth 90% e buxhetit janë shpenzime operative dhe, si të tilla, duhet të mbulohen nga Buxheti i Shtetit. Ndërkaq, shpenzimet zhvillimore, shpesh mund të mbulohen edhe nga kontributet e donatorëve.

Tabela 6. Buxheti i Strategjisë sipas llojit të shpenzimeve

Fusha	Buxheti					
	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
Shpenzimet zhvillimore	€ 369,500	€ 226,700	€ 133,700	€ 86,500	€ 31,500	€ 847,900
Shpenzimet operative	€ 372,600	€ 997,200	€ 1,532,700	€ 2,163,600	€ 2,636,100	€ 7,385,400
	<b>€ 742,100</b>	<b>€ 1,223,900</b>	<b>€ 1,666,400</b>	<b>€ 2,091,700</b>	<b>€ 2,509,200</b>	<b>€ 8,233,300</b>

Kalkulimet buxhetore janë bërë pasi ka përfunduar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018 dhe, për këtë arsye, për vitin 2016 janë planifikuar më pak shpenzime operative se në vitet tjera, ndërsa ekzistojnë mundësi reale që pjesa më e madhe e shpenzimeve zhvillimore për këtë vit të sigurohen nga burimet e donatorëve.

Në vijim prezantojmë buxhetin e detajuar për secilin objektiv dhe masë strategjike, veç e veç. Masat strategjike janë zbërthyer në aktivitete, ndërsa për secilin aktivitet është përcaktuar kostoja, periudha e zbatimit, si dhe përgjegjësia për zbatimin e tij. Nëse shumat janë lënë të zbrazëta, atëherë është menduar se ato nuk kanë ndonjë kosto shtesë, përveç shpenzimeve të zakonshme që bën institucioni përgjegjës për zbatimin e tyre.

## Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë

<b>Masa 1.1</b> Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	BUXHETI(EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.1.1	Kryerja e vlerësimeve të jashtme të shkollave	2017-2020	Inspeksioni i arsimit	350 shkolla në vit Kostoja për një ekspert vendor për shkollë: 3 DP x 50 EURO/ditë = 150 EUR		52,500	52,500	52,500	52,500	210,000
1.1.2	Ofrimi i mbështetjes në vlerësimet e jashtme shkollore	2017-2019	Inspeksioni i arsimit me mbështetjen e donatorit	Ekspertiza ndërkombëtare : 100 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 100 ditë pune x 200 EUR		25,000	25,000	25,000		75,000
Subtotali 1.1					-	77,500	77,500	77,500	52,500	285,000
<b>Masa 1.2</b> Aplikimi i Ciklit të Menaxhimit të Sigurimit të cilësisë në arsim										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.2.1	Përgatitja e një Doracakut për Menaxhimin e Ciklit të cilësisë në arsim	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare : 50 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 50 ditë pune x 200 EUR	50,000					50,000
Subtotali 1.2					50,000	-	-	-	-	50,000
<b>Masa 1.3</b> Fuqizimi i organeve shkollore (aktiveve dhe këshillave) për të kryer funksionin e tyre të SC-së dhe emërimin e koordinorit të cilësisë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.3.1	Emërimi i koordinorëve të SC-së në shkolla	2016-2020	Komunat	1,100 shkolla x 1 Koordinator i cilësisë x 10% e punës (mesatare) x 450 EURO pagë mujore 2016: 100 koordinor të SC-së 2017-2020: 250 koordinorë të SC-së/vit	54,000	189,000	324,000	459,000	594,000	1,620,000

1.3.2	Emërimi i udhëheqësve të departamenteve në shkolla	2016-2020	Komunat	1,100 shkolla x 5 udhëheqës departamentesh x 5% e orarit të punës (mesatare) x 450 EURO pagë mujore 2016: 100 shkolla x 5 udhëheqës departamentesh 2017-2020: 250 shkolla x 5 udhëheqës departamentesh/vit	135,000	472,500	810,000	1,147,500	1,485,000	4,050,000
Subtotali 1.3					189,000	661,500	1,134,000	1,606,500	2,079,000	5,670,000
<b>Masa 1.4</b>	Definimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.4.1	Krijimi i grupeve profesionale në nivel komunal	2016-2018	Komunat	Mesatarisht - 7 persona për komunë 36 Komuna x 7 persona x 600 EURO (kompensimi vjetor) 2016: 6 Komuna 2017-2018: 15 komuna çdo vit	25,200	88,200	151,200	151,200	151,200	567,000
1.4.2	Emërimi i anëtarëve të personelit të DKA-ve përgjegjës për SC	2016	Komunat	10 DKA-të mund të kenë nevojë të punësojnë personel të ri Paga vjetore: 4,800 EUR	48,000	48,000	48,000	48,000	48,000	240,000
Subtotali 1.4					73,200	136,200	199,200	199,200	199,200	807,000
<b>Masa 1.5</b>	Sigurimi i veprimeve të Inspektoratit të arsimit në aspektin ligjor-administrativ - dhe pedagogjik- profesional									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.5.1	Përgatitja e udhëzuesit dhe procedurave për vlerësim të jashtëm	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare 30 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 30 ditë pune x 200 EURO	30,000					30,000

1.5.2	Caktimi i inspektorëve arsimor për vlerësim të jashtëm të shkollave	2016	MASHT	Sasia e punës vjetore (shkollat vlerësohen çdo 3 vjet): 350 shkolla x 2 inspektor x 5 DP = 3,500 DP: 230 = 15 EOP (Ekuivalent me orar të plotë) Pagat vjetore: 15 EOP x 4,800 EURO/vit= 72,000 EURO	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000	360,000
1.5.3	Caktimi/punësimi i inspektorëve për inspektim administrativ	2016-2017	MASHT	2016: 8 anëtar personeli x 4,800 EURO paga vjetore 2017-2020: 15 anëtar personeli x 4,800 EURO paga vjetore	38,400	72,000	72,000	72,000	72,000	326,400
Subtotali 1.5					140,400	144,000	144,000	144,000	144,000	716,400
<b>Masa 1.6</b>	Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.6.1	Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve	2016-2018	MASHT							-
Subtotali 1.6					-	-	-	-	-	-
<b>Masa 1.7</b>	Përdorimi efektiv i të dhënave monitoruese të arsimit për të gjitha nivelet e SC-së									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1.7.1	Përdorimi efektiv i të dhënave monitoruese të arsimit për të gjitha nivelet e SC-së	2018-2020	MASHT Komunitat Shkollat							-
Subtotali 1.7					-	-	-	-	-	-

**Totali i Objektivit 1: 452,600 1,019,200 1,554,700 2,027,200 2,474,700 7,528,400**

## Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune

<b>Masa 2.1</b> Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
2.1.1	Krijimi i grupit punues për rishikimin e udhëzuesve ekzistues për planet zhvillimore të shkollave.	2016	MASHT							-
2.1.2	Hartimi i udhëzimeve të reja administrative për planet zhvillimore të shkollave dhe instrumentet përkatëse	2016	Grupi punues	Ekspertiza ndërkombëtare: 20 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 20 ditë punë x 200 EURO  Kostot e tjera: 1000 EURO	21,000					21,000
Nën- totali 2.1					21,000	-	-	-	-	21,000
<b>Masa 2.2</b> Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
2.2.1	Zhvillimi i monitorimit dhe korniza mbështetëse për planet zhvillimore të shkollave	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare: 20 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 20 ditë punë x 200 EURO  Kostot e tjera: 1000 EURO	21,000					21,000
2.2.2	Monitorimi i implementimit të planeve zhvillimore të shkollave	2017-2020	Komunat							-
Nën- totali 2.2					21,000	-	-	-	-	21,000

<b>Masa 2.3</b>		Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali	
2.3.1	Hartimi i një doracaku për planifikimin komunal të arsimit	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare: 20 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 20 ditë punë x 200 EURO  Kostot e tjera: 1000 EURO	21,000						21,000
Nën- totali 2.3					21,000	-	-	-	-	-	21,000
<b>Masa 2.4</b>		Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali	
2.4.1	Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira	2016-2020	MASHT Komunat								-
Nën- totali 2.4					-	-	-	-	-	-	-

**Totali i Objektivit 2:    63,000                    -                    -                    -                    -                    63,000**

### ***Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet***

<b>Masa 3.1</b>		Ngritja e kapaciteteve të Inspektimit për përgjegjësitë e reja								
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali



3.1.1	Ngritja e kapaciteteve për inspektorët e arsimit	2016-2017	MASHT me mbështetje nga donatorët	Seminare trajnimi për inspektorët (4 seminare, 25 pjesëmarrës, 3 ditë secili Kostoja e paraparë për seminar - 11,500 EURO: 1 trajner ndërkombëtar x 5 DP x 800 EURO/ditë = 4000 EURO 2 Trajner vendor x 5 DP x 250 EURO/ditë = 2,500 EUR Akomodimi (f/b): 30 persona x 3 ditë = 90 mëditje x 50 EUR = 4,500 EUR Kostot e tjera: 500 EURO	23,000	23,000					46,000
3.1.2	Vizita studimore për inspektorët e arsimit	2016-2017	MASHT me mbështetje nga donatorët	40 fluturime në shtetet e tjera, 5 ditë secila - 1,500 EUR/fluturimi	30,000	30,000					60,000
Subtotali 3.1					53,000	53,000	-	-	-	-	106,000
<b>Masa 3.2</b>	Hartimi i doracakut për aktivitetet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali	
3.2.1	Krijimi i grupit punues për hartimin e doracakut	2016	MASHT								-
3.2.2	Hartimi i doracakut për aktivitetet e shkollave	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare: 30 ditë pune x 800 EURO (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 30 ditë pune x 200 EURO  Kostot e tjera: 2000 EUR	32,000						32,000
3.2.3	Organizimi i sesioneve informuese në shkolla/komuna	2017-2018	MASHT	Mesatarisht 3 sesione informuese për komunë Kostoja e një sesioni: 300 EURO 2 moderatorë x 100 EURO/ditë Pijet freskuese: 100 EUR 2017: 54 sesione 2018: 54 sesione		16,200	16,200				32,400

Subtotali 3.2					32,000	16,200	16,200	-	-	64,400
<b>Masa 3.3</b> Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
3.3.1	Hartimi i doracakut për sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë dhe instrumentet përkatëse	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare: 30 ditë pune x 800 EUR (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 30 ditë pune x 200 EUR  Kostot e tjera: 2000 EUR	32,000					32,000
3.3.2	Ngritja e kapaciteteve të shkollave për menaxhim të cilësisë	2017-2020	komuna	1100 koordinatore të SC në shkolla + 2 përfaqësues nga secila shkollë = 3,300 pjesëmarrës +100 nga DKA/të = 3,400 pjesëmarrës (110 seminare, 2 ditë secili, 30 pjesëmarrës)  Kostoja e paraparë për një seminar - 1,050 EUR: 2 trajnerë x 2 ditë x 150 EURO/ditë = 600 EURO Dreka dhe pijet freskuese: 30 persona x 2 ditë x 5 EURO = 300 EURO Materiali i trajnimit: 30 pjesëmarrës x 5 EURO = 150 EURO 2017: 20 seminare 2018-2020: 30 seminare/vit		21,000	31,500	31,500	31,500	115,500
Subtotali 3.3					32,000	21,000	31,500	31,500	31,500	147,500
<b>Masa 3.4</b> Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali

3.4.1	Hartimi i një doracaku për grupet profesionale komunale	2016	MASHT	Ekspertiza ndërkombëtare: 20 ditë pune x 800 EUR (të gjitha shpenzimet të përfshira) Ekspertiza vendore: 20 ditë pune x 200 EUR  Kostot e tjera: 1000 EUR	21,000						21,000
3.4.2	Ngritja e kapaciteteve të grupeve profesionale komunale	2016-2018	MASHT me ndihmën e komunave	36 komuna x 10 anëtarë ekipi, përfshirë zyrtarët e DKA-ve (mesatarisht) = 360 pjesëmarrës (30 seminare, 3 ditë secili, 25 pjesëmarrës)  Kostoja e paraparë për një seminar - 3,100 EURO: 2 trajnerë x 3 ditë 250 EURO/ditë = 1,500 EURO Dreka dhe pijet freskuese 30 persona x 3 ditë 15 EUR = 1,350 EURO Materialet e trajnimit: 25 pjesëmarrës x 10 EURO = 250 EUR 2016: 5 seminare 2017: 15 seminare 2018: 10 seminare	15,500	46,500	31,000				93,000
Subtotali 3.4					36,500	46,500	31,000	-	-		114,000
<b>Masa 3.5</b>	Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
					2016	2017	2018	2019	2020	Total	

3.5.1	Ngritja e kapaciteteve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor	2016-2019	komuna	1100 shkolla x 2 përfaqësues nga secila shkollë = 2,200 pjesëmarrës në trajnim +100 nga DKA-të = 2,300 pjesëmarrës në trajnim (75 seminare, 3 ditë secili, 30 pjesëmarrës)  Kostoja e paraparë për një seminar - 1,500 EURO: 2 trajnerë x 3 ditë 150 EURO/ditë = 900 EURO Dreka dhe pijet freskuese: 30 persona x 3 ditë 5 EUR = 450 EURO Materialet e trajnimit: 30 pjesëmarrës x 5 EURO = 150 EURO 2016: 15 seminare 2017-2019: 20 seminare/vit	22,500	30,000	30,000	30,000		112,500
Subtotali 3.5					22,500	30,000	30,000	30,000	-	112,500
<b>Masa 3.6</b>	Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Total
3.6.1	Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla	2018-2020	MASHT Komunitat Shkollat							-
Subtotali 3.6					-	-	-	-	-	-

**Totali i Objektivit 3: 176,000 166,700 108,700 61,500 31,500 544,400**

#### Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë

<b>Masa 4.1</b>										
Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
4.1.1	Zhvillimi i softuerit për përpunimin dhe raportimin e rezultateve të testeve kombëtare	2016	MASHT	Kostoja e Softuerit	30,000					30,000
Subtotali 4.1					30,000	-	-	-	-	30,000
<b>Masa 4.2</b>										
Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
4.2.1	Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve	2017-2020	MASHT Komunitat							-
Subtotali 4.2					-	-	-	-	-	-
<b>Masa 4.3</b>										
Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
4.3.1	Përgatitja e materialeve promovuese për informimin e prindërve më organizimet e SC-së	2016-2017	MASHT	Përgatitja e fletëpalosjeve: 500 EURO Kostoja e printimit: 50,000 kopje x 0.20 EURO	5,500	5,000				10,500
4.3.2	Fushata informuese në media elektronike	2017	MASHT	Paushall		30,000				30,000
Subtotali 4.3					5,500	35,000	-	-	-	40,500
<b>Masa 4.4</b>										
Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim										

Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
4.4.1	Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim	2016-2020	MASHT Komunitat Shoqëria Civile							-
Subtotali 4.4					-	-	-	-	-	-
<b>Masa 4.5</b>	Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë									
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)					
					2016	2017	2018	2019	2020	Totali
4.5.1	Zhvillimi i portalit interaktiv për SC	2016	MASHT	Paushall	15,000					15,000
4.5.2	Operimi i portalit	2017-2020	Inspeksioni i arsimit	Paga e Administratorit të portalit (50% e sasisë së punës) ~ 3,000 EURO/vit		3,000	3,000	3,000	3,000	12,000
Subtotali 4.5					15,000	3,000	3,000	3,000	3,000	27,000

**Totali i Objektivit 4:    50,500    38,000    3,000    3,000    3,000    97,500**

## Referencat

AKK (2013), Plani Strategjik i Kolegjiut të Arsimit 2013-2016. Asociacioni i Komunave të Kosovës: Prishtinë.

Ligji(2004), Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë . Prishtinë: Kuvendi i Kosovës .

MASHT (2014),Statistikat e Arsimit në Kosovë 2013/14. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2014b), Udhëzim Administrativ Nr. 25/2014 për Licencimin e Mësimdhënësve . Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë .

MASHT (2014c), Udhëzimi Administrativ Nr. 8/2014 për Procedurat dhe kriteret e Zgjedhjes për drejtorët e Shkollave dhe Zëvendësdrejtorëve . Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Murafa, C. (2013), Quality Assurance in Basic Education in Southeast Europe – Ëhat ëorks in our region. Bucharest: Romanian Academic Society.

Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02 (2014), Shqyrtim i Instrumenteve Ekzistuese të SC-së në Nivel Shkollë, DKA dhe MASHT (Draft Raport). Prishtinë: mbështetje për Zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016.

Grupi i Bankës Botërore (2014), Country Snapshot-Kosovo. Prishtina: The world Bank Country Office in Kosovo.

The development of the  
QA strategy was supported by:

BM

BF

KULTUR  
kontakt  
AUSTRIA